



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 162

Tiranë – E enjte, 9 nëntor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 312, datë 1.11.2023	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19535
Dekret i Presidentit nr. 313, datë 1.11.2023	Për lejin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 19535
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 28, datë 16.10.2023	Për kushtet dhe procedurat për transferimin nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz) në arsimin profesional dhe anasjelltas..... 19535
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 4.7.2023	Çështja Thanza kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 41047/19</i>)..... 19538
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 3.10.2023	Me objekt konstatimin se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përcaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile. Anulimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Përsheptimin e gjykimit dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, të kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022..... 19568
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër nr. 530 (3497), datë 18.7.2023	Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Eralba Mehaj..... 19579

**DEKRET****Nr. 312, datë 1.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 13, si dhe nenit 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Ledia Arben Noppe (Gjoka)
2. Andi Eduard Papa
3. Loredana Argjir Bardhi
4. Kastriot Zef Prenga
5. Eni Bejo Duka
6. Besmir Kamber Braho

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET**Nr. 313, datë 1.11.2023****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, nenit 93 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, 20 e në vijim të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, shtetasve të mëposhtëm:

1. Gerta Jonus Isaku
2. Serbie Mentor Stafasani (Çeliku)
3. Deivid Roland Profiti
4. Joana Grigor Foto
5. Ervin Shkelqim Sylaj
6. Hannah Ervin Sylaj
7. Halid Ervin Sylaj
8. Liljana Ervin Sylaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

**UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 28, datë 16.10.2023****PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT
PËR TRANSFERIMIN NGA ARSIMI I
PËRGJITHSHËM (GJIMNAZ) NË
ARSIMIN PROFESIONAL DHE
ANASJELLTAS**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 20, pika 5, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJMË:

Neni 1
Qëllimi

Ky udhëzim i përbashkët ka për qëllim të përcaktojë kushtet dhe procedurat për realizimin e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional dhe anasjelltas.

Neni 2

**Kushtet për transferim nga arsimi i mesëm
profesional, në arsimin e përgjithshëm
(gjimnaz)**

1. Kanë të drejtë të transferohen në gjimnaz nxënësit që kanë përfunduar klasën e dhjetë të arsimit të mesëm profesional.



2. Nxënësit duhet të plotësojnë kriterin e moshës, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.

3. Transferimi nga arsimi i mesëm profesional, në gjimnaz bëhet me miratim të Zyrës Vendore Arsimore Parauniversitare (ZVAP) përkatëse.

Neni 3

Procedurat e transferimit nga arsimi i mesëm profesional, në arsimin e përgjithshëm (gjimnaz)

1. Procedurat e transferimit fillojnë pas përfundimit të vitit shkollor dhe vijnë deri në fund të muajit korrik.

2. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, bën aplikimin *online* për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania*, në shërbimin përkatës dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit të nxënësit;

b) dëftesën e klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional.

3. ZVAP-ja, ku është paraqitur aplikimi për transferim, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga përfundimi i afatit për aplikim, kryen procedurat si vijon:

a) Vlerëson dokumentacionin e aplikimit dhe miraton ose refuzon kërkesën për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania*. Për rastet kur kërkesa refuzohet, ZVAP-ja duhet të argumentojë shkaku të refuzimit;

b) Krahason planin mësimor të klasës së 10-të të arsimit të mesëm profesional që ka përfunduar nxënësi, me planin mësimor të klasës së 10-të të gjimnazit ku nxënësi dëshiron të transferohet. Në rast se nga krahasimi i planeve mësimore, rezulton se në arsimin profesional ka të paktën 6 lëndë/module të pazhvilluara, atëherë nxënësi duhet të përsërisë klasën e 10-të;

c) Njofton zyrtarisht drejtorinë e institucionit arsimor ku nxënësi do të transferohet për lëndët / modulet e pazhvilluara dhe të zhvilluara pjesërisht.

4. Drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar, menjëherë pas marrjes së njoftimit zyrtar nga ZVAP-ja për transferimin e nxënësit, cakton mësuesit e secilës lëndë të pazhvilluar ose të zhvilluar pjesërisht, për t'i dhënë nxënësit orientimet e nevojshme, për t'u përgatitur për kryerjen e provimeve për këto lëndë.

5. Provimet për lëndët e zhvilluara pjesërisht, kryhen vetëm për pjesën e programit mësimor të përcaktuar, e cila përcaktohet nga mësuesi lëndor dhe miratohet nga drejtoria e institucionit arsimor parauniversitar.

6. Nxënësi i kryen këto provime në sesionin e vjeshtës, sipas procedurave të përcaktuara për provimet e këtij sesioni.

7. Nxënësi shtetas shqiptar apo i huaj, i cili transferon studimet nga arsimi i mesëm profesional i kryer jashtë shtetit, në gjimnaz, në Republikën e Shqipërisë, duhet të njohë dhe njehsojë dëftesën e përfundimit të klasës së 10-të. Ata nuk mund të ripërsërisin lëndë për të cilat janë vlerësuar njëherë.

8. Pas përfundimit të procedurave të transferimit, shkolla pritëse njofton zyrtarisht shkollën nga është transferuar nxënësi, për regjistrimin e nxënësit. Të dy shkollat bëjnë shënimet përkatëse në amëz.

9. Dokumentacioni i transferimit ruhet në sekretarinë e institucionit arsimor parauniversitar dhe është objekt inspektimi, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Kushtet e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional

1. Transferimi i nxënësit nga gjimnazi, në arsimin e mesëm profesional lejohet vetëm brenda 3-mujorit të parë të klasës së 10-të. Ky rregull vlen edhe kur nxënësi ka ndjekur arsimin e përgjithshëm parauniversitar jashtë vendit.

2. Për t'u transferuar nxënësi duhet të plotësojë detyrimet e planit mësimor (lëndët dhe modulet profesionale) të drejtimit përkatës të arsimit të mesëm profesional ku kërkon të transferohet.

3. Nxënësit të cilët transferojnë studimet nga jashtë shtetit në Republikën e Shqipërisë, për periudhën e 3-mujorit të parë të vitit të parë të arsimit të mesëm të përgjithshëm, duhet të paraqesin programin mësimor të ndjekur në atë shtet, të përkthyer dhe noterizuar me vulë apostile.

4. Nxënësit duhet të plotësojnë kriterin e moshës të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për sistemin arsimor parauniversitar.



Neni 5

Procedurat e transferimit nga arsimi i përgjithshëm (gjimnaz), në arsimin e mesëm profesional

1. Personi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, bën aplikimin *online* për transferim, nëpërmjet platformës *e-albania* dhe ngarkon dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin e identifikimit të nxënësit;

b) Vërtetimin e ndjekjes së gjimnazit nga data e fillimit të shkollës deri në momentin e aplikimit. Vërtetimi përmban lëndët e zhvilluara, rezultatet për çdo lëndë, frekuentimin, si dhe masat disiplinore, nëse ka.

2. Drejtoria e shkollës së arsimit të mesëm profesional, ku nxënësi dëshiron të transferohet, brenda 5 (pesë) ditë pune, nga kryerja e aplikimit, kryen këto procedura:

a) Vlerëson dokumentacionin e aplikimit dhe miraton ose refuzon kërkesën për transferim;

b) Për të dy rastet, miratim apo refuzim, krahas njoftimit nëpërmjet platformës *e-albania*, njofton edhe zyrtarisht (me shkresë ose *email*) personin që ushtron përgjegjësinë prindërore. Për rastet kur kërkesa refuzohet, duhet të jepet edhe shkaku i refuzimit.

c) Në rast miratimi, njofton zyrtarisht drejtorinë e shkollës nga vjen nxënësi, për miratimin e transferimit. Të dyja shkollat, transferuese dhe pritëse, bëjnë shënimet përkatëse në dokumentacionin shkollor sipas legjislacionit në fuqi.

d) Cakton mësuesit e lëndëve/moduleve profesionale të pazhvilluara ose të zhvilluara pjesërisht gjatë 3-mujorit të parë, të cilët do të mbështesin nxënësit për plotësimin e boshllëqeve në përgatitjen teorike dhe praktike profesionale.

3. Mësuesit sipas shkronjës “d”, të pikës 2, të këtij udhëzimi, brenda tremujorit të dytë testojnë dhe vlerësojnë me notë nxënësit, për lëndët/modulet profesionale përkatëse.

4. Në përfundim të vlerësimit, mësuesit dokumentojnë dhe dorëzojnë në drejtorinë e shkollës rezultatet e vlerësimit, të cilat pasqyrohen në dokumentacionin shkollor.

5. Dokumentacioni i transferimit ruhet në sekretarinë e institucionit arsimor dhe është objekt inspektimi.

Neni 6

Dispozitat e fundit

1. Lëndë/module të pazhvilluara plotësisht konsiderohen ato lëndë/module të cilat janë në planin mësimor të shkollës ku nxënësi dëshiron të transferohet, por nuk janë në planin mësimor të shkollës nga vjen nxënësi.

2. Lëndë/module të zhvilluara pjesërisht janë ato lëndë/module të cilat në planin mësimor të shkollës ku nxënësi dëshiron të transferohet, zhvillohen me më shumë orë mësimore në javë, nga sa janë zhvilluar në shkollën nga vjen nxënësi.

3. Vlerësimi përfundimtar për lëndët e zhvilluara pjesërisht është mesatarja aritmetike e vlerësimit të shkollës nga vjen nxënësi, me vlerësimin e komisionit të shkollës ku nxënësi është transferuar.

4. Udhëzimi i përbashkët nr. 21, datë 9.7.2015, “Për procedurat e transferimit të nxënësve nga një nivel/drejtimit i arsimit profesional në gjimnaz”, shfuqizohet.

5. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, ofruesit e arsimit dhe formimit profesional dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCVE
DHE EKONOMISË

Ervin Mete

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ogerta Manastirliu



GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA THANZA KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 41047/19)

VENDIM

Neni 6 § 1 (civil) – Gjykim i drejtë – Shkarkim i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbështetur në gjetjet e procesit të vetingut – Mundësi e papërshtatshme për të kundërshtuar konstatimet faktike në lidhje me vlerësimin e figurës dhe për ta mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive – Zbatim tepërt formal i parashikimeve ligjore vendëse përkatëse në lidhje me vlerësimin e integritetit për lidhje të mundshme me krimin e organizuar – Asnjë problematikë në lidhje me pjesën e proceseve për vlerësimin e pasurisë dhe integritetit financiar

Neni 8 – Jeta private – Shkarkim i justifikuar mbështetur në konstatimet e individualizuara nga vlerësimi i pasurisë dhe i integritetit financiar – Gjetjet faktike të organeve të vetingut dhe interpretimi i ligjit vendës jo arbitrar apo qartazi i paarsyeshëm – Asnjë mangësi serioze në procesin e vendimmarrjes – Arsye konkrete dhe të mjaftueshme

STRASBURG

4 korrik 2023

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë sipas parashikimeve të nenit 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen Thanza kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *kryetar*,

Jolien Schukking,

Georgios A. Serghides,

Darian Pavli,

Ioannis Ktistakis,

Andreas Zünd

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit*,
Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 41047/19) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”), nga një shtetas shqiptar, z. Admir Thanza (“kërkuesi”), më 29 korrik 2019;

vendimin për të bërë me dije Qeverinë Shqiptare (“Qeveria”) për ankesat në mbështetje të neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës dhe për të deklaruar të papranueshme pjesën e mbetur të kërkesës;

komentet e palëve të treta marrë nga Res Publica, së cilës i ishte lejuar nga Kryetari i Seksionit të ndërhynte në procedurën me shkrim (neni 36 § 2 i Konventës dhe Rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 6 qershor 2023,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

HYRJE

1. Çështja konkrete ka të bëjë me rezultatin e procesit të rivlerësimit (i njohur ndryshe si “vetingu”) ndaj kërkuesit, proces i cili rezultoi në shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.

FAKTET

2. Kërkuesi ka lindur në vitin 1969 dhe banon në Tiranë. Ai u përfaqësua nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga Agjentja e saj, znj. E. Muçaj, dhe në vijim nga z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbledhen si më poshtë.

I. INFORMACIONE MBI ZHVILLIMET E PËRGJITHSHME

5. Kërkuesi shërbeu si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Shkodër nga viti 1992 deri më 1996, dhe si Kryetar i kësaj gjykate për disa vite; si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë nga viti 2006 deri në vitin 2009; si anëtar i Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë nga viti 2009 deri në vitin 2013; dhe si gjyqtar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë nga viti 2013 deri në shkarkimin e tij nga detyra gjatë procesit të vetingut (shih paragrafin 34 më poshtë).

6. Në përputhje me Ligjin për Deklarimin e Pasurive (Ligji nr. 9049 i datës 10 prill 2003),



kërkuesi paraqiti deklaratimet vjetore të pasurive pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktëve të Interesit (“ILDKPKI”, shih paragrafin 68 më poshtë). Rezulton se ILDKPKI nuk ka gjetur asnjë mospërputhje apo pasaktësi në deklaratimet e tij ndër vite, deri në deklarinimin për vetingun për pasuritë të depozituar në vitin 2017 (shih paragrafin 11 më poshtë). Në kohën kur kërkuesi u emërua në Gjykatën Kushtetuese në vitin 2009, dhe më pas në Gjykatën e Lartë në vitin 2013, ai iu nënshtrua vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (“DSIK”), vlerësim të cilin e kaloi.

7. S.B. u mbajt në arrest për dyshimin për abuzim me detyrën (neni 248 i Kodit Penal). Bashkëshortes së tij (L.H.) iu përgjuan bisedat telefonike. Më 31 janar dhe 4 shkurt 2016, kërkuesi u takua me L.H., një mike e vjetër e familjes së tij, e cila, sipas tij, ishte notere publike pa rekorde kriminale. Më 8 prill 2016, ndaj tyre u çel një hetim në mbështetje të neneve 244 dhe 259 të Kodit Penal (korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike dhe korrupsion pasiv nga personat që ushtrojnë funksione publike). Me anë të një vendimi të datës 29 korrik 2016, Prokuroria e Përgjithshme e ndërpreu hetimin për mungesë të veprës penale, duke iu referuar nenit 328 § 1 (b) të Kodit të Procedurës Penale (“akti nuk përbën një veprë penale”; shih paragrafin 66 më poshtë). Në vendimin e pushimit të hetimit pohohej se “marrëdhënia [me L.H.] [ishte] shoqërore dhe [se] nuk përfshihej asnjë interes korruptiv”. Edhe pse vendimi për pushim të hetimit mund të kundërshtohet pranë Gjykatës së Lartë, rezulton se nuk u paraqit asnjë apelim.

8. Ndërkohë, në muajin prill 2016, kërkuesi paraqiti një formular vetëdeklarimi në përputhje me Ligjin e ri të Dekriminalizimit (Ligji nr. 138/2015 “Për sigurimin e integritetit të personave që ushtrojnë, të zgjedhur apo të emëruar në funksione publike”) duke deklaruar mungesën e shkaqeve të tillë si rekorde të mëparshme kriminale për vepra të rënda, që e pengonin të emërohej ose të shërbente në një detyrë publike (shih paragrafin 71 më poshtë). Formulari i vetëdeklarimit u miratua me anë të një vendimi parlamentar pas hyrjes në fuqi të atij Ligji. Kërkuesi u përgjigj me “jo” pyetjes së bërë nëse ishte hetuar, gjykuar apo dënuar në Shqipëri, ose në ndonjë shtet tjetër (shih paragrafin 72 në vijim).

9. Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori reforma të thella në sistemin e drejtësisë, duke ndryshuar Kushtetutën dhe duke kaluar në fuqi një sërë statutesh në lidhje me, midis të tjerash, rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve në detyrë (në vijim “procesi i vetingut”, shih *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, §§ 4-7, 9 shkurt 2021). Procesi i vetingut u realizua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (“KPK”) në shkallë të parë dhe – në rastin e një apelimi – nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (“KPA”) pranë Gjykatës Kushtetuese (së bashku referuar si “organet e vetingut”). Organet e vetingut do të rivlerësonin çdo gjyqtar në detyrë sipas tre kriterëve: i. vlerësimi i pasurive (në vijim referuar si “vlerësimi i pasurive”); ii. kontrolli i figurës që kishte për qëllim gjetjen e lidhjeve të mundshme me krimin e organizuar (në vijim referuar si “vlerësimi i figurës”); dhe iii. vlerësimi i kompetencës profesionale. Në përfundim të secilit grup të proceseve të rivlerësimit, organet e vetingut do të duhej të jepnin një vendim të arsyetuar ku konfirmonin në detyrë ose pezullonin ose shkarkonin nga detyra personin e rivlerësuar.

II. PROCESI I VETINGUT PËR KËRKUESIN

10. Si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, kërkuesi iu nënshtrua procesit të vetingut me prioritet. Në janar 2017, ai plotësoi dhe dorëzoi formularët standard të deklaratimit si në vijim: një deklaratë të vetingut për pasuritë, një deklaratë për integritetin dhe një formular vetëvlerësimi. Në deklarinimin e tij të pasurive, kërkuesi deklaroi, *inter alia*, një apartament me sipërfaqe 149 m² në Tiranë, të marrë në vitin 2009 për 112,000 euro kryesisht me të ardhurat nga shitja e një apartamenti tjetër në Tiranë dhe të ardhurat nga puna e tij dhe të bashkëshortes së tij. Gjithashtu, ai deklaroi një apartament me sipërfaqe prej 136 m² me garazh në Shkodër, të marrë në prill 2000 me të ardhurat nga profesioni dhe të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në nëntor 2000. Kërkuesi iu përgjigj negativisht pyetjeve në formularin e deklaratimit të integritetit (shih paragrafin 64 në vijim).

A. Parashtime nga autoritete të tjera publike

11. ILDKPKI gjykoi se deklarimi për vetingun i kërkuesit për pasuritë ishte i pasaktë dhe në mospërputhje me ligjin; se nuk kishte burime financiare të ligjshme që të justifikonin pasuritë; se kërkuesi kishte fshehur pasuritë dhe kishte bërë



deklarim fals; dhe se nuk ishte në situatën e një konflikti interesi.

12. Sipas nenit 39 të Ligjit të Vetingut (shih paragrafin 63 në vijim), më 2 nëntor 2017, “DSIK” i dërgoi KPK-së një shkresë. Në të shkruhej si më poshtë:

“Lënda: Dërgohet raporti për kontrollin e figurës [së kërkuesit]

Për: KPK

Në mbështetje të nenit 39 të [Ligjit të Vetingut], pas përfundimit të procedurës për kontrollin e figurës nga grupi i punës për [kërkuesin], DSIK ju informon si më poshtë:

1. Duke iu referuar deklaramit [të kërkuesit] për figurën, ne shqyrtuam me kujdes dosjen e tij dhe i shkruam SHISH (Shërbimit Informativ Shtetëror, SHÇBA (Shërbim i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme) dhe Prokurorisë së Përgjithshme, për të realizuar procedurën e kontrollit të figurës.

a. Deklarimi ishte i plotë dhe i plotësuar në përputhje me Ligjin e Vetingut. Pas një diskutimi nga anëtarët e grupit të punës, u vendos të kërkohej verifikimi i figurës nga këto autoriteteve.

2. ... Sipas shkresës “konfidenciale” të Prokurorisë së Përgjithshme të datës 8 shtator 2017, shkresës ‘sekret’ të SHISH të datës 25 tetor 2017 dhe shkresës “konfidenciale” të SHÇBA-së të datës 22 gusht 2017;

b. Duke pasur në konsideratë nenin DH § 4 të Aneksit të Kushtetutës, [kërkuesi] plotësoi formularin e deklaramit në mënyrë të pasaktë duke mosdeklaruar proceset në përputhje me parashikimin e neneve 244 dhe 259 të Kodit Penal të pushuara më 29 korrik 2016.

c. Informacionet janë marrë duke ngritur dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3. Mbështetur në vlerësimin e të gjitha informacioneve të disponueshme për autoritetet e verifikimit për [kërkuesin], ne gjykojmë si më poshtë:

Sipas nenit 39(2) të [Ligjit të Vetingut], ai ka bërë deklarime të pasakta në formularin e deklarimeve, konkretisht në paragrafin 5, pjesa 5, ‘Të dhëna për sigurimin’, duke mos deklaruar kontaktet e papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Ky mosdeklarim rezultoi në

përgjegjësinë për fshehjen e faktit, plotësimin e pasaktë dhe të pavërtetë të formularit të deklaramit.

Pas [vendimit për pushim] në vitin 2006 për përfshirjen e gjyqtarit në aktivitete të lidhura me korrupsionin në formën e rryshfetit për kryerjen e veprimeve ose për mosveprimet në lidhje me funksionin e tij gjyqësor, [kërkuesi] konsiderohet një person me prirje drejt aktiviteteve kriminale dhe një person i cili mund të vendoset lehtë nën presion nga strukturat kriminale; një vlerësim i mbështetur në nenin 37(b) dhe (c) të [Ligjit të Vetingut].

Gjithashtu, sipas nenit 3(8) të Ligjit, që i referohet akteve kriminale sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale, [kërkuesi] është i përfshirë në aktivitete të paligjshme, të zbuluara në formën e korrupsionit.

Sipas nenit 38 (4) të Ligjit, ekzistojnë informacione se ai ka pasur kontakte të papërshtatshme.

Mbështetur në analizën e vendimit të mësipërm, kemi vendosur se [ka pasur] kontakt të papërshtatshëm me person(a) të përfshirë në krimin e organizuar, sipas interpretimit të nenit 3(15) të Ligjit.

4. Rezulton se grupi i punës ka konstatuar papërshtatshmërinë e vijimësisë [së kërkuesit] në detyrë.

Ju lutemi, gjeni bashkëngjitur raportin për rivlerësimin [e kërkuesit] dhe [vendimin për pushimin] të vitit 2016.”

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor (“KLJ”) identifikoi disa të meta në lidhje me kompetencën profesionale të kërkuesit në vlerësimin e punës së tij në gjyqësor, si për shembull mungesa e raportit të relatorit, mungesën e datës ose të nënshkrimit në raportet e këshilltarëve dhe mungesën e të dhënave të caktuara në listimet e seancave dëgjimore. Sidoqoftë, KLJ-ja ishte në favor të konfirmimit të kërkuesit në detyrë.

14. Prokuroria e Përgjithshme informoi KPK-në se nuk kishte informacione apo indicie nga agjencitë ligjzbatuese për përfshirjen e kërkuesit në vepra penale apo cenim të figurës së tij. Gjithashtu, regjistrat e informacioneve të klasifikuara që prej vitit 2012 nuk kishin të dhëna apo indicie nga agjencitë ligjzbatuese për hetimet kundër tij. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Shkodër informoi KPK-në se ndaj tij nuk kishte nisur asnjë proces disiplinor dhe se prokuroria nuk kishte asnjë informacion për përfshirjen e tij apo për kontakte



me anëtarët e organizatave kriminale, me persona të dënuar ose me persona të dyshuar për vepra penale.

B. Procesi në KPK

1. Hetimi nga KPK-ja

15. KPK-ja kreu një hetim administrativ mbështetur në tre kritere rivlerësimi. KPK-ja i shkroi DSIK-së duke i kërkuar “deklasifikim të plotë të informacionit të klasifikuar si ‘sekret shtetëror’ me anë të shkresës së datës 2 nëntor 2017. Një kopje e asaj shkrese (shih paragrafin 12 më sipër) që u dorëzua nga palët në Gjykatë u vulos si e deklasifikuar plotësisht më 1 mars 2018”.

16. Në muajin mars 2018, KPK-ja ftoi kërkuesin t’i përgjigjej disa pyetjeve shtesë, njëra prej të cilave ishte si në vijim: “A keni qenë më parë i ndaluar, hetuar, i ndjekur penalisht, i akuzuar apo i dënuar në Shqipëri apo në ndonjë vend të huaj?” Ai u përgjigj duke dërguar një përmbledhje të detajuar në lidhje me hetimin për korrupsion të vitit 2016 (shih paragrafin 7 më sipër). Gjithashtu, ai u pyet nëse njihje shtatë individë, emrat e të cilëve ishin të përcaktuar, dhe nëse kishte marrë masa ose nëse kishte bërë konsultime profesionale, ose në kishte marrë vendime ose nëse kishte kontribuar në vendimmarrjen në lidhje me këta individë ose familjarët e tyre ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë ndaj një subjekti ku ata mund të kishin qenë ose ishin administratorë, pronarë ose partnerë, menaxherë ose kishin interesa të tjerë; dhe nëse ai kishte pasur kontakt personal vullnetar me njerëz të përfshirë në procese civile, penale ose administrative përtej komunikimeve formale (zyrtare). Kërkuesi u përgjigj, duke përmendur miqësinë e tij me L.H. në lidhje me pyetjen e fundit.

17. Më 28 maj 2018, kërkuesi mori gjetjet e hetimit të KPK-së, ndër të cilat deklarohesh, *inter alia*, si më poshtë:

a) Për sa i përket apartamentit prej 136 m² në Shkodër, çmimi i tij i deklaruar prej 3,000,000 lekë (ALL) nuk përkonte me çmimin prej 1,200,000 lekësh (afërsisht 9,000 euro) të deklaruar në kontratën e blerjes. Ky çmim i fundit nuk dukej se reflektonte vlerën reale të një apartamenti të ri të blerë nga ndërtuesi, duke qenë një çmim disa herë më i ulët sesa çmimi mesatar i tregut në vitin 2000 në Shkodër. Gjithashtu, shuma e përcaktuar si shpenzime shtesë për apartamentin nuk ishte vërtetuar, dhe të ardhurat nga këto shitje në muajin nëntor 2000 nuk mund të ishin përdorur për të blerë këtë apartament në muajin prill 2000. Për sa i përket

apartamentit në Tiranë, shuma prej 4,000,000 lekësh e deklaruar në deklarin e vitit 2003 të pasurive nuk përkonte me çmimin prej 1,950,000 lekësh në kontratën e blerjes. Një analizë financiare e deklarimeve periodike gjatë viteve konstatoi një mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara dhe të dhënave të dokumentuara dhe midis të ardhurave neto dhe shpenzimeve të bëra nga familja e kërkuesit. Për periudhën 2003-05, 2007, 2008 dhe 2016, gjendja bankare ishte negative, dhe për pasojë nuk ekzistonte mundësia për të bërë depozitime, kursime ose për të përballuar shpenzime të tilla si blerjet e pronave gjatë atyre periudhave. Për analizat financiare të sipërpërmendura, KPK-ja bashkëlidhi një sërë tabelash dhe përlllogaritjesh dhe theksoi se metodologjia e përdorur reflektonte në parashtrimet bashkëlidhur.

b) Gjetjet në lidhje me komponentin e dytë të procesit të vetingut (vlerësimi i figurës) konstatonin se DSIK-ja kishte kryer një hetim mbi verifikimin e deklarimeve dhe të dhënave të tjera dhe përmbledhje të parashtrimit të saj të datës 2 nëntor 2017 (shih paragrafin 12 më sipër).

18. Më 6 qershor 2018, kërkuesi kërkoi akses në dokumentacionin dhe metodologjinë e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës dhe aktiveve likuide për periudhën 2003-08. Atij iu dha materiali në dosjen e çështjes, duke përfshirë parashtrimet e DSIK-së, ILDKPKI-së dhe KLGJ-së (shih paragrafët 12-13 më lart) si dhe, siç rezultoi, shkresat e organeve tatimore mbi të cilat janë bazuar përlllogaritjet, dhe metodologjia e përdorur për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës dhe aktiveve likuide. Më 8 qershor 2018, kërkuesi kërkoi një shtyrje dhjetëditore të afatit kohor për paraqitjen e parashtrimeve. Më 11 qershor 2018, KPK-ja caktoi si afat të ri datën 22 qershor 2018.

19. Më 22 qershor 2018, kërkuesi paraqiti vërejtje dhe dokumente, të tilla si një raport ekspertit për gjendjen financiare të familjes së tij në vitet 1992-2002, me qëllim që të provonte se ai kishte pasur të ardhura dhe kursime të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë. Ai gjithashtu deklaroi se i vetmi dokument i bashkëngjitur parashtrimit të DSIK-së ishte vendimi i ndërprerjes së 2016-ës dhe se ishte e arsyeshme të arrihej në përfundimin se ai bazohej në atë dokument dhe në asnjë provë tjetër.

20. Më 28 qershor 2018 kërkuesi u informua se një seancë dëgjimore ishte caktuar në datën 4 korrik 2018. Më 3 korrik 2018, KPK-ja e informoi



kërkuesin se kishte shqyrtuar të dhënat financiare për vitet 1992-2002 dhe i kishte ofruar atij një vlerësim financiar të ndryshuar si dhe metodologjinë për atë. Ky i fundit tregoi se përlogaritja e shpenzimeve të jetesës bazohej në të dhënat e ILDKPKI-së (shuma e llogaritur për të gjithë periudhën, në raport me vitet për të cilat ka pasur detyrimin për të deklaruar, për të përcaktuar shpenzimet mesatare vjetore). KPK-ja e riprogramoi seancën për në datë 10 korrik 2018. Kërkuesi u informua se ai mund të bënte parashtrime me shkrim deri më 6 korrik 2018.

2. Vendimi i KPK-së

21. Kërkuesi dhe avokati i tij bënë parashtrime me shkrim dhe me gojë dhe paraqitën prova në seancën dëgjimore të datës 10 korrik 2018. Ato u pranuan në dosje për shqyrtim nga paneli i KPK-së. Me vendim të datës 17 korrik 2018, KPK-ja shkarkoi nga detyra kërkuesin dhe bëri konstatimet e mëposhtme.

a) Vlerësim i pasurive

i. Apartamente dhe garazhe në Shkodër dhe Tiranë

22. Në deklarimin e tij të parë të pasurisë për vitin 2003, dorëzuar në muajin mars 2004 dhe në deklarimin e pasurisë për vetingun të dorëzuar në vitin 2017, kërkuesi kishte deklaruar një apartament me një sipërfaqe prej 136 m² në Shkodër blerë me familjen e tij në prill të vitit 2000, me vlerë të deklaruar prej 3 000 000 lekë, ku kërkuesi dhe bashkëshortja e tij zotërojnë 50% të aksioneve. Deklarimi i vitit 2003 përmbante një version tjetër të së njëjtës faqe të hartuar në vitin 2005, ku në njërin tregohet çmimi i blerjes prej 1,200,000 lekë dhe 1,800,000 lekë si shpenzime shtesë, kryesisht të bëra pas muajit nëntor 2000. Kjo situatë ishte e parregullt për sa i përket procedurave në ILDKPKI, në mungesë të ndonjë procesverballi apo shënimi në dosje. Çmimi në kontratën e blerjes ishte 1 200 000 lekë, një çmim që ishte më i ulët se çmimi mesatar i tregut për një apartament të ri në Shkodër në vitin 2000. Banesa ishte deklaruar e blerë në muajin prill 2000 me të ardhurat nga shitja e dy apartamenteve në nëntor 2000. Koha dhe shumat (tej çmimit të blerjes) e ndryshimeve/punimeve të pretenduara në apartament nuk vërtetoheshin nga dokumentacioni përkatës. Garazhi i blerë me apartamentin ishte deklaruar fillimisht në deklarimin për vetingun dhe nuk ishte përmendur në deklarimin e vitit 2003.

23. Në kontratën e blerjes nuk ishte specifikuar se apartamenti ishte shitur i papërfunduar (gjendje

karabina), gjë që sipas argumentit të kërkuesit mund të shpjegonte një çmim më të ulët. Ishte specifikuar se apartamenti mund të përdorej nga blerësit, mund të regjistrohej menjëherë prej tyre dhe ishte pa asnjë detyrim apo hipotekë. Apartamenti ishte pjesë e një pallati, çka nënkuptonte se ky i fundit ishte kontrolluar dhe regjistruar si i përfunduar dhe funksional. Të ardhurat nga shitjet në muajin nëntor 2000 kishin siguruar vetëm 1 000 000 lekë dhe nuk kishte asnjë provë që 800 000 lekë të mbetura vinin nga një burim i ligjshëm. Nga të dhënat e disponueshme rezultoi se çmimi i deklaruar prej 3 000 000 lekësh – dhe, *a fortiori*, çmimi i blerjes 1 200 000 lekë – për një apartament të asaj madhësie me garazh ishte të paktën gjysma e çmimit të tregut për vitin 2000. Kërkuesi nuk kishte vërtetuar bindshëm pse shitësi kishte bërë një shitje nën vlerën e tregut. Për sa i përket faqes së modifikuar në deklarimin e vitit 2003, duke supozuar se është bërë pas kërkesës së ILDKPKI-së, ajo duhej të ishte regjistruar.

24. Kështu, kërkuesi kishte bërë një deklaratë të pamjaftueshme, të paplotë dhe të pasaktë, duke dhënë shpjegime kontradiktore dhe jo bindëse, veçanërisht në lidhje me burimet financiare të përdorura për blerjen e apartamentit në muajin prill 2000.

25. Për sa i përket apartamentit prej 113 m² në Tiranë, blerë në vitin 2003 dhe në pronësi të bashkëshortes deri në shitjen e tij në ose rreth vitit 2009, kërkuesi e kishte deklaruar me vlerën 4,000,000 lekë. Ai apartament ishte deklaruar në deklarimin për vetingun si burim i përdorur për krijimin e një pasurie tjetër, një apartament në pronësi kur nisi procesi i vetingut. Në kontratën e blerjes për atë apartament të parë ishte përcaktuar një çmim prej 1,950,000 lekësh. Edhe nëse pranohej shpjegimi se diferenca e konsiderueshme prej 2,050,000 lekësh kishte të bënte me deklarimin e shpenzimeve shtesë, nuk kishte asnjë provë se ato shpenzime ishin kryer. Kërkuesi kishte bërë një deklaratë të pasaktë dhe të pamjaftueshme në lidhje me çmimin e blerjes së atij apartamenti. Rezulton se çmimi i specifikuar në kontratë ka qenë – si në disa raste të tjera – fiktiv, për të shmangur normën tatimore dukshëm më të lartë që zbatohet për shumatat mbi 2,000,000 lekë. Kështu, kishte arsye për të dyshuar nëse ndryshimet e pretenduara në apartament ishin kryer menjëherë pas blerjes, ose nëse ishte paguar shumata e shpenzimeve përkatëse.



26. Në deklarimin e vetingut, kërkuesi kishte deklaruar një garazh në Tiranë të blerë nga bashkëshortja e tij në vitin 2007 për 400,000 lekë. Ky garazh nuk ishte deklaruar në asnjë nga deklaratimet vjetore të pasurisë. Kërkuesi e kishte fshehur atë pasuri dhe kishte bërë një deklaratim të rremë.

27. KPK-ja arriti në përfundimin se kërkuesi nuk kishte respektuar Ligjin e Deklarimit të Pasurive (Ligji nr. 9049/2003) dhe nenin 32 të Ligjit të Vetëingut, i cili justifikonte shkarkimin e tij sipas nenit 61(3) të Ligjit të Vetëingut, si dhe për garazhin në Tiranë, sipas nenit D § 5 të Aneksit të Kushtetutës.

ii. Vlerësimi financiar

28. Periudha 1992-2002 është shqyrtuar me kërkesë të kërkuesit dhe në bazë të të dhënave që ai kishte dhënë. Duke marrë parasysh të ardhurat neto dhe të ardhurat nga veprimtaria profesionale e bashkëshortes, në vitet 1992-2003, 2004, 2005, 2008 dhe 2009 nuk kishte të ardhura të mjaftueshme për të kryer shpenzimet dhe për të bërë kursimet e deklaruara në deklaratimet vjetore. Të dhënat e deklaruara ndër vite shpesh nuk përputheshin me dokumentacionin që gjendej në KPK. Për vitet 1992-2003 ka pasur një bilanc negativ prej 2,772,865 lekësh. Nga viti 2004 deri në vitin 2016 bilanci ka qenë negativ për katër vite dhe gjatë kësaj periudhe shpenzimet me burime financiare të pajustificuara kanë arritur në 4,427,471 lekë. Të ardhurat e bashkëshortes së tij nuk ishin deklaruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2006. KPK-ja rrëzoi argumentin që synonte të vërtetonte shpenzime të konsiderueshme më të ulëta të jetesës. KPK-ja vlerësoi se një kosto standarde minimale e jetesës – 440 lekë në ditë për person (rreth 3,50 euro) deri në vitin 2007 dhe 352 lekë deri në vitin 2016 – kishte qenë e zbatueshme në mbarë vendin, pavarësisht se ku jetonte një person në vend. Kërkuesi kishte bërë një deklaratim të pamjaftueshëm dhe nuk kishte burime të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet, gjë që justifikonte zbatimin e nenit D § 3 të aneksit të Kushtetutës dhe shkarkimin e tij sipas nenit 61(3) të Ligjit të Vetëingut.

b) Vlerësimi i figurës

29. Kërkuesi e kishte plotësuar me gabime dhe në mënyrë të pavërtetë deklarimin për figurën. Duke marrë parasysh parashtrimin e DSIK-së (shih paragrafin 12 më lart) dhe nenin 38(1) të Ligjit të Vetëingut, ai kishte pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe

mund të vihej nën presion prej tyre. Ai nuk kishte ofruar prova bindëse për të vërtetuar të kundërtën.

30. Kërkuesi kishte dështuar të deklaronte hetimin penal të vitit 2016 (shih paragrafin 7 më lart) dhe të specifikonte rrethanat lehtësuese nëse ishte e përshtatshme. Mosdeklarimi përbënte një deklaratim të pasaktë sipas interpretimit të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39(2) të Aktit të Vetëingut (shih paragrafët 54 dhe 63 në vijim). Vendimi i formës së prerë erdhi si rezultat i një procesi gjyqësor të rregullt me garanci për palët dhe vlerësimin e provave nga një gjykatë, në përputhje me parimin e kontradiktoritetit, me pjesëmarrjen e të gjithë palëve të interesuara, të cilët mund të ushtronin të drejtat e tyre. Vendimi i një prokurori për të ndërprerë hetimin nuk pati të njëjtin efekt, sepse ai mund të rihapej në çdo moment. Ligji nr. 10 192/2009 parashikonte një përjashtim vetëm kur një vendim si i pafajshëm shpallej me një vendim gjyqësor të formës së prerë, ashtu si në nenin 3(15) të Ligjit të Vetëingut (shih paragrafin 59 më poshtë). Legjislacioni nuk i lejonte DSIK-së hapësirë për interpretim ose liri në vlerësim dhe listonte vetëm një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm në lidhje me shpalljen e një personi si të përfshirë në krimin e organizuar, përkatësisht shfajësimin e plotë nga një gjykatë. Standardi për vlerësimin e figurës shkonte përtej faktit të dënimit për vepra penale. Sipas nenit 39(2) të Ligjit të Vetëingut, kërkuesi duhej të deklaronte çdo kontakt të papërshtatshëm në deklarimin për figurën, duke u mbështetur në përkufizimin e nenit 3(15) të Ligjit të Vetëingut.

31. KPK-ja miratoi si të mirëpërcaktuara gjetjet e DSIK-së në lidhje me “prijet e kërkuesit drejt aktiviteteve kriminale”; se ai mund të vihej “lehtë nën presionin e strukturave kriminale”; dhe se ai kishte [kishte] “kontakte të papërshtatshme”. Ndërsa këto gjetje duhej të vlerësoheshin dhe të përdorreshin “me një sy kritik dhe analizë logjike”, ato ishin marrë nga agjencia e specializuar sipas nenit 38(1) të Aktit të Vetëingut. KPK-ja nuk konstatoi ndryshe gjatë hetimit të saj dhe bazuar në dokumentet para saj. As kërkuesi nuk i kishte kundërshtuar këto gjetje. Kështu, duhej të zbatohej neni DH i Aneksit të Kushtetutës dhe shkarkimi sipas nenit 61(2) të Ligjit të Vetëingut.

c) Vlerësimi i kompetencës profesionale dhe i çështjeve që lidhen me etikën dhe integritetin

32. Në këtë kategori, KPK-ja mori në konsideratë, *inter alia*, çështje të përmendura në



raportin e KLGJ-së, pjesëmarrjen e kërkuarit në procese në lidhje me një kompani private dhe një dhuratë monetare të marrë prej saj, si edhe një *sentenza patteggiamento* (një formë e një procedure të thjeshtuar të krahasueshme me gjykimin e shkurtuar) në Itali në vitin 1999.

d) Përfundim i përgjithshëm

33. Etika dhe integriteti i kërkuarit ishin të dyshimtë për faktin se përveç deklarimeve në deklaratimet e vetë, në disa raste në deklaratimet e tij para KPK-së ai kishte mohuar të vërtetën për marrjen e një dhurate mbi 500 euro, për dhënien e vendimeve në çështjet që përfshinin kompaninë private që ia kishte dhuruar ato para, ose për procesin në Itali. Duke pasur parasysh nenin 4(2) të Ligjit të Vetëgjitur dhe duke bërë një vlerësim të përgjithshëm të veprimeve dhe mosveprimeve të kërkuarit, si dhe pamundësinë për të provuar se kishte burime të ligjshme financiare për të justifikuar shpenzimet dhe pasuritë, KPK-ja arriti në përfundimin se ai kishte dëmtuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, në të cilin ai kishte shërbyer në nivele të larta për shumë vite. Për rrjedhojë, KPK-ja vendosi shkarkimin e tij në mbështetje të nenit 61(5) të Aktit të Vetëgjitur.

C. Procesi në KPA

34. Kërkuari apeloj në KPA. KPA-ja e njoftoi atë se çështja do të shqyrtohej sipas procedurës së zakonshme me shkrim, pra, pa seancë publike dhe në mungesë të tij. Me një vendim të datës 18 prill 2019, KPA-ja la në fuqi vendimin e KPK-së të datës 17 korrik 2018 dhe gjykoj si më poshtë.

1. Vlerësim i pasurive

a) Në lidhje me pasuritë

35. Apartamenti në Shkodër ishte deklaruar – në deklaratimin e parë vjetor dhe në deklaratimin e vetëgjitur – i blerë në prill 2000 për 3,000,000 lekë, me të ardhurat nga shitjet në nëntor 2000 dhe të ardhurat e bashkëshortëve nga puna. Çmimi i blerjes ishte shumë më i ulët se kostot e supozuara shtesë. Ato ishin gjithashtu më të larta se kostot mesatare të ngjashme në vitin 2000 për një apartament të sapondërtuar. Nga kontrata e blerjes nuk rezultonte se apartamenti ishte në gjendje të pabanueshme, ndaj çmimi i përmendur në kontratë dukej i pasaktë. Kërkuari kishte shkelur Ligjin e Deklarimit të Pasurive dhe nenin 32 të Ligjit të Vetëgjitur, i cili justifikonte shkarkimin e tij sipas nenit 61(3) të Ligjit të Vetëgjitur.

36. Dy banesat e tjera ishin shitur për 1,100,000 lekë, ndërsa shpenzimi – me pretendimin se ishte kryer me ato para – ishte 1,800,000 lekë. Duke bërë vlerësimin e saj financiar, KPA-ja konfirmoi se kërkuari kishte shpenzuar atë shumë, por arriti në përfundimin se një pjesë e shpenzimit (700,000 lekë) nuk kishte ardhur nga një burim i ligjshëm. Kërkuari kishte një bilanc negativ për vitet 1992-2003. Çmimi i përcaktuar në kontratë për apartamentin dhe garazhin (1,200,000 lekë) ishte shumë më i ulët se çmimi mesatar i tregut për një apartament të ngjashëm në Shkodër (3,512,200 lekë). Duke zbatuar të dhënat zyrtare të disponueshme për vitin 2000, kostoja mesatare e ndërtimit e miratuar për vitin 2000 ishte 25,825 lekë për metër, e cila për atë apartament dhe garazh arriti në 4,080,350 lekë. Edhe nëse pranohet se apartamenti ishte blerë i papërfunduar, kjo vlerë ishte akoma më e lartë se vlera e deklaruar prej 3,000,000 lekësh.

37. Kërkuari kishte deklaruar se çmimi i blerjes (1,200,000 lekë) ishte paguar në muajin prill 2000 nga të ardhurat e familjes, ndërsa të ardhurat nga shitja e banesave të tjera në muajin nëntor 2000 ishin përdorur për të mbuluar kostot shtesë (1,800,000 lekë). Në deklaratimin e vitit 2003, ai i kishte deklaruar ato të ardhura si burime të përdorura për blerjen e apartamentit. Në deklaratimin e vetëgjitur ai kishte shtuar të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes. Në muajin prill 2000, kërkuari nuk kishte pasur kursime ose të ardhura të mjaftueshme për të blerë banesën.

38. Për banesën në Tiranë, vlera (4,000,000 lekë) e përmendur në deklaratimin e vitit 2003 nuk përputhej me çmimin e përcaktuar në kontratën e blerjes (1,950,000 lekë). Në ILDKPKI është bërë një deklaratim i pamjaftueshëm, pasi kërkuari kishte deklaruar më shumë se dyfishi i shumës në kontratë, pa vërtetuar shpenzimet për punimet e pretenduara. Këto veprime shkelnin Ligjin për Deklarimin e Pasurive dhe nenin 32 të Ligjit të Vetëgjitur. Kostoja mesatare e një prone të tillë ishte 6,039,850 lekë. KPA-ja gjykoj se palët në kontratën e blerjes kishin rënë dakord të vendosnin një çmim më të ulët në kontratë që korrespondonte me shumën minimale të tatimit që duhej paguar. Kjo pasuri kishte të bënte me analizën financiare për vitet 1992-2003, e cila rezultoi në një bilanc negativ prej 1,339,709 lekësh. Kështu, të ardhurat e disponueshme kishin qenë të pamjaftueshme për të blerë atë apartament në vitin 2003, pasi një tjetër apartament ishte blerë në vitin 2000. Kërkuari kishte bërë një deklaratë të



pamjaftueshme sipas nenit D § 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, së bashku me nenin 33(5)(b) të Ligjit të Vetingut, i cili justifikonte shkarkimin e tij nga detyra sipas nenit 61(3) të Ligjit të Vetingut.

justifikoheshin mangësitë në dokumentacion (si mungesa e provave për aktivitetet mbi njëzet vjet ose mungesa e dokumenteve bankare). Legjislacioni nuk merrte parasysh ndryshimet e shpeshta në ligjet fiskale dhe financiare, ekonominë informale në vitet e para të demokracisë, mungesën e detyrimit për të mbajtur fatura kur kjo nuk ishte kërkuar shprehimisht nga ligji dhe fakti që institucionet shtetërore i kishin mbajtur dokumentacionet financiare për një periudhë të kufizuar. E gjithë kjo krijoi vështirësi të mëdha për të vërtetuar ligjshmërinë e pasurisë, veçanërisht përpara hyrjes në fuqi të Ligjit për Deklarimin e Pasurive (Ligji nr. 9049/2003). Kjo duhet të kishte një peshë të konsiderueshme në rastin e tij, ku vlerësimi i pasurisë ishte përqendruar rreth të ardhurave të krijuara dhe shpenzimeve të bëra në vitet 1992–2003. Organet e vetingut ndoqën një qasje rigorozë të pajustificueshme në dëm të tij, ndërsa në raste të ngjashme kishin pranuar situatën e ekonomisë informale si rrethanë lehtësuese për pasaktësitë në deklaratimet vjetore në të shkuarën.

ii. Qeveria

93. Kërkuesi kishte marrë pjesë në hetimin administrativ, më pas kishte pasur akses në të gjithë materialin në dosjen e çështjes para KPK-së dhe kishte pasur kohë të mjaftueshme për të bërë parashtrësia dhe për të paraqitur prova, duke përfshirë periudhën para dhe gjatë seancës dëgjimore para KPK-së. KPK-ja i kishte pranuar provat në dosjen e çështjes dhe i kishte shqyrtuar së bashku me provat e tjera. Atij i ishte dhënë një zgjatje e afatit në qershor 2018 dhe më pas ai nuk kishte kërkuar asnjë zgjatje tjetër.

94. Shpenzimet për jetesën për vitet 1992–2003 ishin vlerësuar me kërkesë të kërkuesit dhe duke iu referuar raportit të një eksperti të kërkuar prej tij. KPK-ja kishte marrë në konsideratë të dhënat e marra nga ILDKPKI-ja dhe ishte mbështetur në minimumin jetik. Nëse do të ishte bërë një përllogaritje më e detajuar, llogaritja e shpenzimeve të jetesës për kërkuesin do të ishte disa herë më e lartë duke shkaktuar një dëm më të madh ndaj tij. Në rastin e tij nuk pati asnjë shmangie nga praktika e vendosur e KPA-së si autoriteti përfundimtar me juridiksion të plotë mbi çështjet e faktit dhe ligjit.

95. Vlerësimi i pasurisë kishte të bënte me deklarinë dhe kontrollin e pasurisë, verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare. Personi i

verifikuar duhet të plotësonte një deklaratë vetingu për pasurinë dhe interesat, dhe të paraqiste dokumentacionin shtesë që e gjykonte të nevojshme për shqyrtimin e ligjshmërisë së pasurisë së deklaruar. Neni 32 i ligjit të Vetingut parashikonte mundësinë e lehtësimit të barrës së provës për një fakt ose rrethanë kur personi provonte se ishte objektivisht i paafte për të paraqitur dokumentin. Kërkuesi nuk kishte pretenduar kurrë se kishte qenë në një situatë të tillë. Ai kishte bërë deklarinë të pasaktë, i mungonin burimet ligjore për të justifikuar pasurinë, kishte bërë deklarinë të rremë dhe kishte fshehur pasuri.

iii. Ndërhyrës si palë e tretë

96. Res Publica iu referua pamundësisë që subjektet e verifikimit të kenë akses në një provë kritike ku deklaratat e pasurisë konsideroheshin të pamjaftueshme, përkatësisht opinioni i një këshilltari financiar. Sipas ligjit të Vetingut dhe rregulloreve të brendshme të organeve të vetingut, dokumentet e përpiluara nga këshilltarët ligjorë dhe financiarë ishin konfidencialë dhe nuk mund të bëheshin publike. Kualifikimet e tyre ishin të diskutueshme dhe lidhjet e tyre të ngushta me organet e vetingut ngritën shqetësime për paanshmërinë e tyre. Ata nuk u kualifikuan si ekspertë por si dëshmitarë kundër një subjekti vetingu.

b) Vlerësimi i Gjykatës

97. Edhe pse aspekti penal i nenit 6 me garancitë specifike sipas paragrafit 3 (a) dhe (b) të tij nuk zbatohen në rastin konkret (shih *Xboxhaj*, cituar më lart, § 246), Gjykata vëren se ankuesi ishte palë në procese me natyrë disiplinore dhe të bazuara në gjetjet paraprake, për sa i përket pikave përkatëse faktike dhe juridike, të bëra fillimisht me anë të një hetimi administrativ. Kërkuesit iu kërkua që t'i kundërshtonte këto gjetje, dhe nëse nuk e realizonte këtë gjë ai mund të shkarkohej nga detyra. Kështu, Gjykata vlerëson se në bazë të aspektit civil të nenit 6 § 1 në lidhje me “të drejtat dhe detyrimet civile” të ankuesit, atij duhej t'i jepej një mundësi e përshtatshme për të kundërshtuar ato gjetje dhe për të mbrojtur çështjen e tij në një mënyrë efektive (shih *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 326 dhe 328).

98. Vihet re se kërkuesit iu dhanë tre ditë, nga 3 deri më 6 korrik 2018, për të rregulluar mbrojtjen e tij duke paraqitur vërejtje me shkrim dhe duke shtuar prova mbi vlerësimin financiar të ndryshuar të KPK-së (shih paragrafin 20 më lart). Gjykata pajtohet me kërkuesin në aspektin se, duke pasur



parasysh natyrën dhe shtrirjen e çështjeve faktike dhe ligjore në fjalë, ajo periudhë duket të ketë qenë mjaft e shkurtër. Megjithatë, në qershor 2018, KPK-ja i dha kërkuessit një zgjatje të afatit kohor për kërkesën e tij (shih paragrafin 18 më lart); atij iu dha mundësia për të studiuar dosjen e çështjes dhe për të bërë parashtrësia dhe për të paraqitur prova. Kërkuessi nuk kërkoj zgjatje të mëtejshme të afatit të caktuar deri më 6 korrik 2018 dhe/ose shtyrje të seancës dëgjimore të listuar për 10 korrik 2018.

99. Pas datës 6 korrik 2018, kërkuessi bëri parashtrime me shkrim dhe me gojë dhe paraqiti prova për çështjet që kanë të bëjnë me vlerësimin e pasurisë dhe veçanërisht me gjetjet e ndryshuara në lidhje me vlerësimin financiar, veçanërisht për vitet 1992–2002. Këto parashtrime u pranuan në dosjen e çështjes për shqyrtim nga KPK-ja. Për më tepër, vihet re se shqyrtimi i këtij aspekti të çështjes fillimisht u nxit nga parashtrimet e vetë kërkuessit, të cilat ai kishte pasur kohë t'i përgatiste përpara datës 22 qershor 2018 (shih paragrafin 19 më lart). Për më tepër, bazuar në gjetjet përfundimtare të KPK-së në vendimin e datës 17 korrik 2018, kërkuessit iu dha më pas një mundësi për të mbrojtur çështjen e tij para KPA-së. Prandaj, duke marrë parasysh procedurat në tërësinë e tyre, Gjykata arrin në përfundimin se e drejta e ankuesit për një gjykim të drejtë nuk ishte shkelur në lidhje me këtë aspekt.

100. Sa i përket vlerësimit financiar të KPA-së, Gjykata vëren se Komisioneri Publik nuk apeloi (krahaso *Sevdari*, cituar më sipër, §§ 9–13 dhe 122), dhe se ankuesi apeloi në KPA kundër vendimit të KPK-së për shkarkimin e tij nga zyra, duke kundërshtuar, ndër të tjera, vlerësimin përfundimtar financiar të KPK-së siç thuhet në atë vendim (shih paragrafët 22-28 më lart). Rezulton se Ligji i Vetingut ofronte mundësinë që KPA-ja të kryente hetimin e vet dhe të transferonte barrën e provës mbi kërkuessin, në një mënyrë të ngjashme me qasjen e ndërmarrë nga KPK gjatë hetimit të saj administrativ (shih paragrafin 56 më lart). Në thelb, kur la në fuqi vendimin e KPK-së, KPA-ja thjesht mbajti një qëndrim të ndryshëm për disa aspekte specifike të llogaritjeve përfundimtare të KPK-së në vendimin e saj, në përgjigje të pikave të apelimit të kërkuessit. Gjetjet e KPA-së u përshkruan qartë në vendimin e saj, u bazuan në ato llogaritje dhe morën parasysh parashtrimet e tij duke i kundërshtuar ato në lidhje me kuantin ose metodologjinë e përdorur. Nuk ka asnjë indicie se KPA-së i është paraqitur

ndonjë parashtrësia apo provë që nuk i është bërë e ditur kërkuessit ose mbi të cilat atij nuk i është dhënë mundësia për të komentuar gjatë procedurës me shkrim përpara saj. Në çdo rast, një refuzim për të zbuluar disa dokumente të brendshme të gjeneruara brenda vetë KSA-së (shih paragrafët 48 dhe 55 më lart) me qëllim lehtësimin e diskutimeve të formacionit gjyqësor në pjesën që lidhet me vlerësimin financiar nuk ka cenuar parashikimet e aspektit civil të nenit 6 të Konventës (krahaso *Letinčić kundër Kroacisë*, nr. 7183/11, §§ 49–51, 3 maj 2016, *Kramareva kundër Rusisë*, nr. 4418/18, § 34, 1 shkurt 2022, dhe rastet e cituara aty).

101. Për sa i përket mospërputhjes së pretenduar në bërjen e një përlllogaritjeje të shpenzimeve vjetore të jetesës (shih paragrafët 28 dhe 91 më lart), Gjykata rithekson se divergjencat në praktikën gjyqësore ndërmjet gjykatave vendëse ose brenda së njëjtës gjykate nuk janë, në vetvete, në kundërshtim me Konventën, në veçanti me nenin 6 (shih *Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë* [DHM], nr. 76943/11, § 116, 29 nëntor 2016). Një shkelje e së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës mund të lindë vetëm nëse ekzistojnë “ndryshime të thella dhe të gjata” në praktikën gjyqësore të gjykatave vendëse; Gjykata më pas duhet të përcaktojë nëse ligji vendës parashikon një mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve; dhe nëse ai mekanizëm është zbatuar dhe, nëse është rasti, për çfarë efekti (po aty). Vendimi i KPK-së për çështjen e kërkuessit dhe rastet e përmendura prej tij janë dorëzuar brenda së njëjtës periudhë, veçanërisht në fazën e hershme të procesit të verifikimit përpara KPK-së në vitin 2018, dhe nuk ka dalë nga asnjë praktikë e mirëpërcaktuar dhe konsistente e KPA-së. Përputhshmëria e praktikës gjyqësore vendëse, rrjedhimisht, nuk duket se ngre një çështje sipas nenit 6 § 1.

102. Thelbi i argumentit të kërkuessit ka të bëjë më tepër me mungesën e pretenduar të një metode të vetme për llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, e cila ndikoi negativisht në argumentin e tij në lidhje me aftësinë e tij për të kursyer në vitet 1990. Ndërsa KPA-ja identifikoi një nevojë për një metodologji uniforme në vitin 2021 (shih paragrafin 91 më lart), Gjykata vëren se qasja e KPK-së në rastin e kërkuessit në vitin 2018 nuk duket të ketë qenë arbitrare ose haptazi e paarsyeshme. Dokumenti i metodologjisë së KPK-së i referohet një vlerësimi të llogaritur në përpjesëtim me vitet për të cilat kishte



detyrim për deklarin. KPK-ja përfundimisht gjykoi se rreth 3 euro në ditë për çdo person në familje duhej të konsideroheshin si kosto minimale e jetesës në atë kohë (shih paragrafin 28 më lart). Gjykata gjykon se vlerësimi i organeve të verifikimit për shpenzimet thelbësore të jetesës në këtë kontekst nuk ishte arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm.

103. Së fundi, Gjykata rithekson se periudhat e parashkrimit sigurojnë siguri juridike, mbrojnë të pandehurit e mundshëm nga pretendimet e vjetra të cilat mund të jenë të vështira për t'u kundërshtuar dhe parandalojnë çdo padrejtësi që mund të lind nëse gjykatave do t'u kërkohej të vendosnin për ngjarjet që kanë ndodhur në të kaluarën e largët në bazën e provave që mund të jenë bërë të pabesueshme dhe të paplota për shkak të kalimit të kohës (shih *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, § 137, GJEDNJ 2013, dhe *Xboxhaj*, cituar më lart, § 348).

104. Siç përcaktohej në *Xboxhaj* (§ 349), duhet të merren parasysh edhe veçoritë e veçanta të proceseve të auditimit të pasurive të përdorura gjerësisht. Duke qenë se pasuritë personale ose familjare akumulohen normalisht gjatë viteve të punës, vendosja e kufijve të rreptë kohorë për vlerësimin e pasurive do të kufizonte dhe do të cenonte në masë të madhe aftësinë e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të fituara nga personi që kontrollohet gjatë karrierës së tij/saj profesionale. Një vlerësim i pasurisë shfaq disa specifika, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, ku shtetit të paditur do të duhej t'i jepej një shkallë më e madhe fleksibiliteti për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rivendosjes dhe forcimit të besimit publik në sistemin e drejtësisë, dhe për garantimin e një niveli të lartë të integritetit që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Mund të jetë gjithashtu një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkelje disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, që do të thotë nëse kjo ka ndodhur në momentin kur është blerë pasuria, ose në një moment të mëvonshëm në kohë kur pasuria është bërë publike në deklarin periodik të pasurive. Një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e kërkuarit sipas nenit 6 § 1 të Konventës duhet të merren parasysh rast pas rasti (po aty). Nuk është në vetvete arbitrar, për qëllimet e aspektit civil të nenit 6 § 1 të Konventës, që barra e provës të kalojë mbi një kërkuar në procedurat e

verifikimit pasi KPK-ja kishte vënë në dispozicion gjetjet paraprake që rezultojnë nga përfundimi i hetimit dhe kishte dhënë akses në provat në dosjen e çështjes (shih *Xboxhaj*, cituar më lart, § 352, dhe rastet e cituara aty).

105. Gjykata rithekson gjithashtu se neni 6 i Konventës nuk parashikon asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave apo mënyrën se si duhet të vlerësohen provat, të cilat janë për rrjedhojë çështje që rregullohen nga ligji vendës dhe gjykatat vendëse (shih, ndër shumë autoritetet e tjera, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 28, GJEDNJ 1999-I). U takon gjykatave vendëse të vlerësojnë rëndësinë e provave të propozuara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano*, cituar më lart, § 198; *Lady S.r.l. kundër Republikës së Moldavisë*, nr. 39804 /06, § 27, 23 tetor 2018; dhe *Xboxhaj*, cituar më lart, § 325).

106. Gjykata vëren, së pari, se raporti i KPK-së i majit 2018 nuk dukej se i bazonte gjetjet e tij në situatën financiare të familjes në vitet 1992–2002, si mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e banesave në 2000 dhe 2003 (shih paragrafin 17 lart). Kërkuesi zgjodhi, si pjesë e strategjisë së tij të mbrojtjes, të sigurojë një raport ekspertit për atë periudhë, i cili bazohej në të dhënat e tij në lidhje me të ardhurat dhe shpenzimet gjatë asaj periudhe të largët. Kjo e shtyu KPK-në t'i përgjigjet këtyre argumenteve.

107. Gjykata vëren, më pas, se karriera gjyqësore e ankuesit filloi në vitin 1992 dhe vazhdoi pandërprerë deri në kohën e procedurave të vetingut në vitin 2018. Që nga viti 2003 ai ishte subjekt i deklarimeve vjetore të pasurisë (shih paragrafët 6 dhe 68 më lart). Gjetjet ndaj tij bazoheshin si në informacionet e dhëna në deklarin e tij të verifikimit të pasurisë ashtu edhe në deklarinimet e mëparshme të pasurisë të depozituara nga ai dhe bashkëshortja e tij. Objektivi i vlerësimit të pasurisë ishte kontrollimi i ligjshmërisë së burimit të përvetësimit të pasurisë dhe verifikimi i vërtetësisë së deklarinimit të pasurisë për vetingun kundrejt deklarimeve të mëparshme vjetore të pasurisë. Pikërisht për këtë arsye organet e vetingut përdorën si provë deklarinimet e mëparshme vjetore të pasurisë që ai kishte depozituar pranë ILDKPKI për të siguruar që të gjitha pasuritë, përfshirë burimet e ligjshme financiare që ishin përdorur për blerjen e tyre, ishin bërë të ditura dhe të justifikuara. Organet



e vetëgjitur në fund shqyrtuan pasuritë, burimet financiare të cilave ishin siguruar në vitet 1990 ose në fillim të viteve 2000. Megjithatë, Gjykata nuk konsideron se kërkuksi ishte vendosur në një pozitë të vështirë për të justifikuar natyrën e ligjshme të burimeve financiare për shkak të kalimit të kohës dhe mungesës së mundshme të dokumenteve mbështetëse. Ai dha të dhënat përkatëse dhe organet e vetëgjitur i morën ato si bazë për vlerësimin e tyre, edhe pse ata bënë përllogaritje të ndryshme në bazë të tyre, veçanërisht për sa i përket aftësisë për të kursyer të familjes (shih paragrafin 102 më lart), dhe bënë gjetje të pafavorshme (krahaso *Sevdari*, cituar më sipër, § 131). Ligji i Vetëgjitur parashikonte rrethana lehtësuese nëse një person i verifikuar nuk ishte objektivisht në gjendje të paraqiste dokumente mbështetëse (shih paragrafin 58 më lart). Ndërsa kërkuksi specifikoi shumat e supozuara të shpenzuara për të bërë ndryshime në apartamente, ai nuk bëri kërkesë për pamundësi për t'i vërtetuar ato, veçanërisht shumë e konsiderueshme në vitin 2003, pra kur ai kishte qenë tashmë subjekt i deklarimit, në vitin 2004, nën Ligjin për Deklarimin e Pasurive (ligji nr. 9049, datë 10 prill 2003).

108. Nga kjo rrjedh se qasja e organeve të verifikimit ndaj komponentit të parë të procesit të vetëgjitur në rastin konkret nuk ngriti çështje që do të sillnin shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

2. Vlerësimi i figurës

a) Parashtrësat e palëve

i. Kërkuksi

109. Kërkuksi argumentoi se atij i ishte refuzuar aksesit në informacionin që kishte shërbyer si bazë për përgatitjen e paraqitjes së DSIK-së pranë KPK-së, veçanërisht kur kjo krijonte një dyshim të arsyeshëm për përfshirjen e tij ose për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Pasi KPK-ja kishte zhvendosur barrën e provës, ai kishte bërë një kërkesë për të studiuar të gjithë dosjen e çështjes, duke përfshirë të gjitha provat e administruara për kontrollin e figurës. Dosja e çështjes nuk përmbante informacione që mbështesin parashtrimin e DSIK-së. Më pas ai ishte ankuar në mënyrë eksplicite në parashtrimet e tij para KPK-së se gjetjet e DSIK-së bazoheshin në informacione që nuk i ishin vënë në dispozicion. Ai më pas kishte përsëritur pretendimet e tij në ankesën para KPA-së. KPA-ja e kishte hedhur poshtë këtë pretendim, duke iu referuar thjesht nenit 39 të Ligjit të Vetëgjitur. Parashtrimi i DSIK-së ishte bazuar në

disa informacione që i ishin fshehur. Ai madje as nuk ishte informuar për përmbajtjen e atyre provave dhe kështu i ishte mohuar çdo mundësi për t'iu kundërvënë pretendimeve. Komisioni i Venecias vlerësoi se përdorimi i informacionit të klasifikuar ishte i arsyeshëm, por vetëm me kusht që informacioni të ishte i favorshëm për subjektin e vetëgjitur.

110. DSIK-ja kishte kompetencën ekskluzive për të zbatuar dhe hequr konfidencialitetin e dokumenteve të klasifikuara. Vendimet e saj nuk mund të kundërshtoheshin para gjykatave ose të rishikoheshin apo të anuloheshin nga organet e vetëgjitur. Ato nuk kishin akses në ato dokumente dhe nuk mund t'i vlerësonin ato (neni 4 i Aneksit të Kushtetutës). Organet e vetëgjitur në rastin e kërkuksit i ishin referuar gjetjeve të bëra në parashtrimin e DSIK-së dhe punës së bërë nga grupi i punës. Ai kishte qenë në disavantazh të qartë duke mos ditur arsyet e shkarkimit të tij, ndërkohë që mbante barrën e provës në përfundim të hetimeve paraprake. DSIK-ja ishte nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të ekzekutivit dhe drejtori i saj emërohej nga Kryeministri. Ajo ishte e ekspozuar ndaj rrezikut të ndërhyrjes politike, siç përshkruhet nga Komisioni i Venecias.

ii. Qeveria

111. Qeveria argumentoi se, sipas nenit 38 të Ligjit të Vetëgjitur, informacioni konfidencial i administruar nga autoritetet publike mund të shqyrtohej nga organet e verifikimit, duke respektuar procesin e drejtë. Kur aksesit në atë informacion nuk ndikon në sigurinë e të tjerëve ose në sigurinë kombëtare, informacioni mund të deklasifikohet dhe të vihet në dispozicion të subjektit të verifikimit. DSIK-ja kishte deklasifikuar raportin e saj dhe “informacionin bashkëngjitur”. Në raport thuhej se ishte bashkëngjitur vendimi për pushim të 2016-ës. E gjithë dosja e lëndës para KPK-së i ishte vënë kërkuksit në dispozicion. Atij i ishte komunikuar raporti dhe ai kishte paraqitur prova dhe kundërshtime për të. Para KPK-së, kërkuksi kishte hedhur poshtë gjetjet e bëra në raportin e DSIK-së, të cilat vërtetonin se ai kishte qenë në dijeni të “provave që shoqëronin raportin”. Ai nuk kishte kërkuar qasje në asnjë informacion konfidencial që mund të ishte “në dosjen e tij”. KPK-ja kishte informuar Qeverinë në vitin 2019 se ai nuk kishte kërkuar që ajo të deklasifikonte ndonjë informacion. Organet e vetëgjitur e kishin marrë



vendimin vetëm në bazë të raportit të DSIK-së dhe vendimit të pushimit së 2016-ës. Gjetjet mbi vlerësimin e historikut kishin të bënin vetëm me atë vendim dhe kontaktin e tij me L.H.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parimet e përgjithshme

112. Gjykata rithekson se mund të ketë interesa konkurruese, të tilla si siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët në rrezik hakmarrjeje ose për të mbajtur metoda të fshehta të policisë për hetimin e krimit, të cilat duhet të peshohen kundrejt të drejtave të palës për krime ose të tjera procedura përkatëse. Megjithatë, vetëm masat që kufizojnë ato të drejta të cilat nuk prekin vetë thelbin e këtyre të drejtave janë të lejueshme sipas nenit 6 § 1. Që të jetë kështu, çdo vështirësi që i shkaktohet palës kërkuese nga një kufizim i të drejtave të tij/saj duhet të jetë mjaftueshëm i balancuar me procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore (shih, siç zbatohet sipas aspektit civil të nenit 6 § 1 të Konventës, *Regner kundër Republikës Çeke* [DHM], nr. 35289/11, §§ 148 dhe 151, 19 shtator 2017). Kur provat janë mbajtur për arsye të interesit publik, Gjykata duhet të shqyrtojë procedurën e vendimmarrjes për të siguruar që, sa më shumë që të jetë e mundur, ajo të jetë në përputhje me kërkesat për të ofruar procedura kundërshtuese dhe barazinë e armëve dhe të përfshijë masa mbrojtëse të përshtatshme për të mbrojtur interesat e personi në fjalë (po aty, dhe *Corneschi kundër Rumanisë*, nr. 21609/16, §§ 86–89, 11 janar 2022, gjithashtu sipas aspektit civil të nenit 6 § 1).

ii. Zbatimi i parimeve në rastin konkret

α) Mosdeklarimi i kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar

113. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se në janar 2017, kërkuesi plotësoi formularin standard të deklarimit për figurën brenda procesit të verifikimit, duke mohuar çdo përfshirje në aktivitete që lidhen me krimin e organizuar ose për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në të, sipas interpretimit të Ligjit të Vetingut (shih paragrafët 10 dhe 64 më lart). DSIK-ja nisi vlerësimin e figurës dhe bëri një parashttrim (“raport”) në KPK (shih paragrafin 12 më lart). Siç tregohet në atë parashttrim, ai bazohej në “dosjen” e kërkuesit dhe të dhëna nga dy agjenci të tjera të specializuara dhe nga Prokuroria e Përgjithshme, çka ishte formalizuar në letrat e klasifikuara të marra prej tyre. Ky “informacion i marrë” krijoi një dyshim të

arsyeshëm për përfshirjen e kërkuesit ose për kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Megjithatë, si në procedurën e vetingut ashtu edhe në Gjykatë, u tha se i vetmi dokument që DSIK-ja i zbuloi KPK-së me parashttrimin e saj ishte vendimi i pushimit të 2016-ës. Është e paqartë nëse letrat e klasifikuara nga dy agjencitë janë dorëzuar në KPK. Gjatë hetimit të saj, KPK-ja e pyeti kërkuesin nëse ai ishte hetuar apo ndjekur penalisht në të kaluarën. Ai dha një përshtkrim të detajuar rreth hetimit në vitin 2016 (shih paragrafin 16 më lart). Gjetjet e hetimit të KPK-së treguan raportin e DSIK-së dhe deklaruan se DSIK-ja kishte kryer një hetim bazuar në deklarata dhe të dhëna të tjera (shih paragrafin 17 më lart). IQC-ja e zhvendosi barrën e provës mbi aplikantin. Ai bëri komente, duke vënë në dukje se asnjë provë, përveç paraqitjes së DSIK-së dhe vendimit të ndërprerjes së 2016-ës, nuk i ishte ofruar (shih paragrafin 19 më lart). KPK-ja më pas e shkarkoi atë nga detyra, ndër të tjera, për moszbulimin e hetimit të vitit 2016 dhe për shkak të gjetjeve të tjera në parashttrimin e DSIK-së.

114. KPK-ja miratoi si të vërtetuar, megjithëse pa ndonjë arsyetim të mëtjetshëm, gjetjet e DSIK-së në lidhje me “prirjen e kërkuesit drejt aktiviteteve kriminale” dhe se ai mund të “vihej lehtësisht nën presion nga strukturat kriminale”. Ky konstatim u bë në bazë të faktit se KPK-ja nuk kishte vendosur ndryshe gjatë hetimit të vet dhe bazuar në dokumentin(et) përpara saj, dhe për shkak se kërkuesi nuk i kishte hedhur poshtë ato gjetje. Në mungesë të ndonjë hollësie të mëtjetshme (në veçanti, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me çdo “strukturë kriminale” dhe kontekstin e krimit të organizuar, qoftë në lidhje me ndonjë kontakt me L.H. apo ndonjë tjetër) KPK-ja dukej se impononte një barrë prove të tepruar, në mos të pamundur, ndaj kërkuesit në rrethanat e çështjes. Të paktën, asgjë në arsyetimin e KPK-së nuk sugjeron se ai kishte qenë i përfshirë në atë që mund të lidhej në mënyrë të arsyeshme me, për shembull, aktivitete të bashkërenduara brenda ose në dobi të një grupi kriminal.

115. Organet e vetingut konstatuan se, në një periudhë të papërcaktuar, kërkuesi kishte “kontakte të papërshtatshme” me “persona” të përfshirë në krimin e organizuar. Megjithatë, DSIK-ja iu referua vetëm kontaktit të tij me një person, L.H. Detajet e kontaktit me persona të tjerë dhe rrethanat në lidhje



me ato raste të “krimit të organizuar” nuk iu zbuluan kërkuesit. Gjykata vlerëson se ai nuk ishte në gjendje të kundërshtonte as pretendimet faktike dhe as klasifikimin e tyre ligjor për qëllime të procesit të vetingut. Vihet re në lidhje me këtë se organet e vetingut nuk nxorën asnjë konkluzion në lidhje me përgjigjen e kërkuesit ndaj pyetjeve shtesë të KPK-së në mars 2018 në lidhje me njohjen e tij me persona të caktuar (shih paragrafin 16 më lart) ose për ndonjë rrethanë që lind në hetim në lidhje me bashkëshortin e L.H. (shih paragrafin 7 më lart).

116. Për më tepër, referenca e KPA-së ndaj nenit 39 të Ligjit të Vetingut mbi arsyet ligjore për refuzimin e aksesit në informacion ose dokumente mund të kuptohet në mënyrë të arsyeshme se ato ekzistonin dhe ishin shqyrtuar nga DSIK-ja dhe/ose ishin paraqitur në KPK dhe/ose panelit të KPA, por nuk iu ofruan kërkuesit (shih paragrafët 44–45 më lart). KPA-ja nuk deklaroi asgjë në lidhje me ndonjë rrethanë që mund të nxiste rekurs ndaj nenit 39 në këtë çështje, ose të sugjeronte se ai ishte zbatuar në përputhje me të drejtat e kërkuesit sipas nenit 6 § 1 të Konventës (krahajo *Regner*, §§ 150–61, dhe *Corneschi*, §§ 90–113, të dyja të cituara më sipër; shih gjithashtu *Turek kundër Sllovakisë*, nr.57986/00, § 115, GJEDNJ 2006 II (ekstrakte), dhe *Bobek kundër Polonisë*, nr. 01, § 57, 17 korrik 2007). Arsyetimi i KPA-së nuk sugjeron që ajo do të merrte në konsideratë, për shembull, nëse shqetësimet për mbrojtjen e një burimi specifik mund të adresoheshin duke kontrolluar, për aq sa është e mundur, identitete ose elementë të tjerë që mund të zbulonin burimin.

117. KPA-ja iu referua gjithashtu nenit A § 1 të Aneksit të Kushtetutës, i cili lejonte kufizime të të drejtave kushtetuese të subjektit të verifikimit, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës. Megjithatë, vihet re se kjo dispozitë parashikon që të drejtat kushtetuese mund të kufizohen me ligj në interes të publikut dhe se kufizime të tilla nuk mund të shkojnë përtej asaj që është e lejueshme sipas Konventës. KPA-ja nuk dha asnjë arsyetim për domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e ndonjë kufizimi të tillë ose përputhshmërinë e tyre me nenin 6 të Konventës – në lidhje me aksesin në dokumente të klasifikuara ose klasifikimin sipas nenit 3 të Ligjit të Vetingut (shih më poshtë) – në rrethanat specifike të rastin aktual.

118. Për ta përmbledhur, për aq sa vlerësimi i figurës mbështetëj në mosdeklarimin e pretenduar

nga ana e kërkuesit të kontakteve me personat e përfshirë në krimin e organizuar, Gjykata konstaton se kërkuesit nuk i ishte dhënë mundësia e duhur për të kundërshtuar gjetjet e bëra nga organet e vetingut dhe për të mbrojtur çështjen e tij në mënyrë efektive (shih *Xboxhaj*, cituar më lart, §§ 326 dhe 328).

β) Kontakti me L.H. dhe procedimet penale të vetë kërkuesit, dhe mosdeklarimi i tyre

119. Në vitin 2016, ankuesi, atëherë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, dhe L.H., shoqja e tij pa precedentë penale të mëparshëm, u hetuan shkurtimisht për korrupsion. Hetimi u ndërpre për mungesë të një veprë penale (shih paragrafin 7 më lart). Sipas KPA-së, nëse një person nën hetim penal për një vepër të listuar nuk shpallet “i pafajshëm” me një vendim gjyqësor të formës së prerë, ai person duhet të konsiderohet “i përfshirë” në “krim të organizuar” dhe kontakti “i papërshtatshëm” do të duhej të zbulohet në deklaratën e vetingut. Mosdeklarimi ose vetë kontakti mund të shërbejë si bazë ligjore për shkarkimin nga detyra. Megjithatë, Gjykata nuk mund të mos vërë re në lidhje me këtë se hetimi u ndërpre me shpejtësi nga një prokuror për shkak se veprimi i kundërshtuar nuk ishte një vepër penale (shih paragrafët 7 dhe 66 më lart). U arrit në përfundimin se kontakti i kërkuesit me L.H. ishte social dhe se nuk kishte interesa korruptive. Prokurori nuk iu referua asnjë arsyeje tjetër sipas nenit 328 të Kodit Penal, i cili ishte renditur edhe në nenin 3 të Ligjit të Vetingut që parashikon që personi në fjalë të konsiderohet “i përfshirë në krimin e organizuar” për qëllime të procesit të vetingut (shih paragrafin 59 më lart). Vihet re se kërkuesi iu referua asaj që dukej të ishte një interpretim detyrues i ligjit nga Gjykata e Lartë në një kontekst ligjor në dukje të rëndësishëm.

120. Megjithatë, për aq sa KPA-ja ishte autoriteti përfundimtar për interpretimin e Ligjit të Vetingut, ishte e domosdoshme të jepej arsyetimi i duhur duke pasur parasysh provat e forta dhe konsideratat e tjera përkatëse (shih, *mutatis mutandis*, *Mihalache kundër Rumanisë* [DHM], nr.54012/10, §§ 93–98 dhe 102–16, 8 korrik 2019, dhe rastet e cituara aty, dhe *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar* [DHM], nr. 25424/09, §§ 94–102, KEDNJ 2013) mbi atë aspekt themelor të çështjes së vetingut. Gjykata vëren se, në fund të fundit, kërkuesi nuk kishte asgjë për t’u përgjigjur në lidhje me procedimin penal të përfunduar në vitin 2016, dhe se arsyetimi i KPA-së duket se ka qenë tepër formalist në një kontekst që kërkonte kujdes



në zbatimin e parashikimeve përkatëse të ligjit vendës.

121. Procedurat disiplinore në lidhje me gjyqtarët mund të kenë pasoja të rënda për jetën dhe karrierën e tyre dhe mund të rezultojnë në shkarkimin nga detyra, që është një rezultat shumë serioz që mbart një shkallë të konsiderueshme paragjykimi. Mënyra në të cilën kryhen procedurat e rishikimit gjyqësor duhet të jetë e përshtatshme për objektin e mosmarrëveshjes, domethënë, në rastin konkret, për natyrën e tyre disiplinore (shih, *mutatis mutandis*, *Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë* [DHM], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, § 196, 6 nëntor 2018). Kjo konsideratë zbatohet me forcë edhe më të madhe për procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve, të cilët duhet të gëzojnë respektin që është i nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre (po aty), dhe duke pasur parasysh se parimi i shtetit të së drejtës përfshin parimin e pandryshueshmërisë së gjyqtarëve gjatë mandatit të tyre (shih *Baka kundër Hungarisë* [DHM], nr. 20261/12, § 172, 23 qershor 2016, dhe *Besnik Cani*, cituar më lart, § 88). Kur një shtet fillon procedura të tilla disiplinore, besimi i publikut në funksionimin dhe pavarësinë e gjyqësorit është në rrezik; në një shtet demokratik, ky besim garanton vetë ekzistencën e shtetit të së drejtës (shih *Ramos Nunes de Carvalho e Sá*, cituar më lart, § 196).

122. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se vlerësimi i kontakteve të kërkuarit me L.H. dhe i procedimit penal të vitit 2016 ngriti gjithashtu shqetësime serioze për të drejtën e tij për një gjykim të drejtë.

y) Përfundimi

123. Duke marrë parasysh gjetjet e sipërpërmendura në mënyrë kumulative, Gjykata arrin në përfundimin se qasja e organeve të vetëgjyqësorisë për vlerësimin e komponentit të dytë të procesit të vetëgjyqësorisë, që rezultoi në gjetje të gjera që konsideroheshin të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra, nuk ishte në përputhje me parashikimin për drejtësi në nenin 6 § 1 të Konventës në rastin konkret. Prandaj ka pasur shkelje të këtij neni në lidhje me komponentin e dytë të procesit të vetëgjyqësorisë.

III. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 8 TË KONVENTËS

124. Ankuesi u ankua se kishte pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të tij nga detyra dhe për shkak të dispozitave të Ligjit për

Avokatët që ndikonin negativisht në aftësinë e tij për të ushtruar profesionin si avokat.

125. Pjesët përkatëse të nenit 8 parashikojnë si më poshtë:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve.”

A. Fushëveprimi i ankesës

126. Në kërkesën e tij në Gjykatë, kërkuari ngriti dy ankesa sipas nenit 8 të Konventës: i. për shkarkimin e tij nga detyra; dhe ii. për ndalimin, sipas legjislacionit në fuqi, për të ushtruar profesionin e tij si avokat privat pas shkarkimit nga detyra.

127. Në vëzhgimet e tij të paraqitura në vitin 2020, kërkuari përmendi gjithashtu se atij i ishte ndaluar rihyrja në sistemin e drejtësisë, aplikimi për punësim në shërbimin civil ose ushtrimi i detyrës si ekspert. Kërkuari nuk ka paraqitur asnjë ankesë në lidhje me këtë në formularin e tij të kërkesës dhe këto nuk janë një shtjellim i ankesave të tij origjinale, mbi të cilat palët kanë komentuar, por përbëjnë çështje të reja që nuk janë përfshirë në kërkesën origjinale (shih *Vool dhe Toomik kundër Estonisë*, nr. 7613/18 dhe 12222/18, §§ 60–61, 29 mars 2022). Kështu, Gjykatës nuk i kërkohet t'i shqyrtojë veçmas ato çështje në rastin konkret (shih, megjithatë, paragrafin 162 më poshtë).

128. Rrjedhimisht, qëllimi i ankimit para Gjykatës është i kufizuar në procedurat e vetëgjyqësorisë që rezultuan në vendimin e KPA-së të datës 18 prill 2019 dhe në ndalimin e pretenduar të kërkuarit për të ushtruar profesionin e avokatit (anëtar i Avokatisë).

B. Pranueshmëria

1. Për sa i përket shkarkimit të kërkuarit nga detyra

129. Qeveria argumentoi se në çështjen e vetëgjyqësorisë ankuesi nuk kishte paraqitur asnjë argument specifik në lidhje me jetën e tij private. Rezultati i kësaj çështje nuk kishte pasur pasoja në aspektin e “rrethit të tij të brendshëm” dhe zhvillimit të marrëdhënieve të tij me të tjerët. Ai kishte një licencë avokati dhe mund të ushtronte profesionin në çdo kohë. Ai gjithashtu kishte një diplomë doktore, duke i mundësuar të ndiqte një karrierë



në fushën akademike. Kërkuesi nuk kishte provuar se pas procedurave të vetëingut, atij i ishin ulur të ardhurat, ose se i kishte ndryshuar standardi i tij i jetesës.

130. Ankuesi argumentoi se shkarkimi i tij nga detyra kishte ndikuar në gjendjen financiare të tij dhe të familjes së tij, për shkak të humbjes së pagës dhe pensionit të ardhshëm, si dhe mundësisë për të krijuar dhe mbajtur marrëdhënie profesionale. Ai ishte shkarkuar nga posti prestigjioz si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, pa asnjë mundësi për të ushtruar më funksione gjyqësore. Mundësitë e punësimit në fushën juridike që korrespondojnë me kualifikimet dhe përvojën e tij profesionale ishin reduktuar në një masë që e bënte të pamundur ushtrimin e profesionit të avokatit. Shkarkimi i tij kishte cenuar reputacionin e tij profesional dhe social në një mënyrë të tillë që kishte ndikuar seriozisht, ndër të tjera, në vlerësimin e tij. Ai ishte kritikuar dhe shkarkuar nga detyra për shkak të performancës së tij si gjyqtar. Arsytet e shkarkimit sugjerorin se ishte prekur reputacioni i tij profesional. Vendimet e organeve të vetëingut e kishin akuzuar për sjellje të pahijshme dhe sjellje kriminale të qëllimshme, prirje kriminale dhe kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Morali i tij ishte vënë në pikëpyetje. Ai kishte qenë në kulmin e karrierës së tij pas më shumë se dy dekadash përkushtimi personal dhe angazhimit profesional. Në sytë e shoqërisë ai vazhdoi të stigmatizohej si një individ i padenjë për të kryer detyra gjyqësore. Kjo kishte ndikuar në aftësinë e tij për të zhvilluar marrëdhënie me botën e jashtme – lidhur me punësimin ose diçka tjetër – në një shkallë shumë të konsiderueshme dhe kishte krijuar vështirësi serioze për të bërë një jetë normale personale dhe për të fituar jetesën.

131. Për arsyet e përmendura në *Xboxhaj* (cituar më lart, §§ 362–66), Gjykata hedh poshtë argumentet e Qeverisë dhe vëren se kjo ankesë nuk është as qartazi e pabazuar dhe as e papranueshme për ndonjë arsye tjetër të renditur në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

2. *Për sa i përket pretendimit për ndalim në ushtrimin e profesionit të avokatit*

132. Qeveria deklaroi se Dhoma e Avokatisë Shqiptare ishte një person juridik, konkretisht një subjekt publik që ushtronte veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur. Sipas Kodit të Procedurës

Administrative dhe Ligjit për Gjykatat Administrative (Ligji nr. 49/2012), subjektet publike kryenin funksione publike dhe veprimtaria e tyre ishte e vetërregulluar. Një vendim i Dhomës mund të kundërshtohet në gjykatat administrative dhe më pas në Gjykatën Kushtetuese. Nga regjistri kombëtar rezultonte se pothuajse të gjithë zyrtarët e shkarkuar gjatë procesit të vetëingut kishin ushtruar detyrën si avokatë. Kërkuesi ishte dhe mbeti i regjistruar në regjistrin e avokatëve që nuk praktikonin profesionin.

133. Kërkuesi argumentoi se ndërsa neni 13(2)(f) i Ligjit për Avokatinë nuk i referohej në mënyrë eksplicite procesit të vetëingut, formulimi i tij ishte i qartë dhe parashikonte që gjyqtarët dhe prokurorët që ishin shkarkuar në procesin e verifikimit nuk do të mund të regjistroheshin si avokatë ose, nëse do të ishin tashmë të regjistruar përpara procesit të vetëingut, atyre do t'u hiqej e drejta e avokatisë, pa asnjë mundësi për t'u regjistruar më. Vetë Ligji i Avokatisë i shkelte të drejtat e tij, edhe në mungesë të masës individuale, sepse ai i përkiste një klase njerëzish që rrezikonin të prekeshin drejtpërdrejt nga ai legjislacion.

134. Gjykata vëren se në asnjë moment gjatë katër viteve që nga përfundimi i procesit të vetëingut në prill 2019, kërkuesi nuk është penguar të ushtrojë profesionin e avokatit. Duke pasur parasysh gjetjet e tij në lidhje me një ankesë të ngjashme në çështjen *Xboxhaj* (cituar më sipër, §§ 371–73), ajo arrin në përfundimin se ankesa e tij është e papajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 § 3 (a) dhe 4.

C. Themeli

135. Ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së tij private për shkak të shkarkimit të tij nga detyra (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 377). Një ndërhyrje në të drejtën e një personi për respektimin e jetës private është në kundërshtim me nenin 8 të Konventës, përveç rastit kur mund të justifikohet sipas nenit 8 § 2 si një masë në përputhje me ligjin, duke ndjekur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura aty, dhe duke qenë e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur qëllimin ose synimet në fjalë.

136. Gjykata vëren se vlerësimi i KPA-së për secilin nga tre komponentët e procesit të vetëingut doli me një përfundim sipas një prej paragrafëve të seksionit 61 në lidhje me arsyet për shkarkim (shih



paragrafët 27, 28, 31, 33, 35 dhe 46–47 më lart). Rrjedhimisht, KPA-ja gjykoj se përfundimi i saj për secilin komponent ishte në vetvete i mjaftueshëm për të justifikuar shkarkimin e kërkuarit nga detyra.

137. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh gjetjet e saj sipas nenit 6 të Konventës, Gjykata së pari do të përcaktojë nëse gjetjet sipas komponentit të parë (kontrolli i pasurisë) justifikonin shkarkimin e ankuesit nga detyra sipas nenit 8 § 2, si një masë në përputhje me ligjin, duke ndjekur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura në të, dhe duke qenë të nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur qëllimin ose synimet në fjalë.

1. Në përputhje me ligjin

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuari

138. “Deklarim i pamjaftueshëm” sipas kuptimit të nenit 61(3) të Ligjit të Vetingut, si arsye për shkarkim, lidhet me nenin 33, ku parashikohet se vlerësimi i pasurisë konstatonte nëse një subjekt i verifikimit me dashje nuk kishte deklaruar pasurinë ose kishte më shumë pasuri sesa mund të shpjegohej në mënyrë legjitime. Subjektet e vetingut duhej të “deklararin” të gjitha pasuritë dhe burimet e të ardhurave të lidhura me to dhe t’i “justifikonin” duke paraqitur dokumentet përkatëse për të shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e tyre të ligjshme. Mosjustifikimi nuk mund të rezultojë në shkarkimin sipas nenit 61(3). “Deklarim i pamjaftueshëm” rezultoi vetëm nga fshehja e pasurisë ose dhënia e një deklarate të rreme. Sipas nenit D § 5 të Aneksit të Kushtetutës, shkarkimi do t’i imponohej kujtdo që do të ndërmernte hapa për të deklaruar ose fshehur në mënyrë të pasaktë pasuritë. Ky nuk ishte rasti kur një subjekt verifikimi i. deklaroi pasurinë dhe burimin e të ardhurave, por nuk ishte në gjendje t’i dokumentonte ato ose legjitimitetin e tyre, ose kur deklarimi i pasurisë përmbante pasaktësi ose mospërputhje të vogla; ose

Faqe | 19562

ndaj pasaktësive në deklaratimet e pasurisë apo mosdeklarimit të tyre.

139. Organet e vetingut e kishin sanksionuar në mënyrë të papërshtatshme kërkuarin për “deklarim të pamjaftueshëm” për, ndër të tjera, deklarimin e një vlere më të lartë për apartamentet në deklaratën e tij të vetingut dhe për plotësimin e gabuar të deklaratave periodike vjetore për pronësinë e një garazhi. Sipas neneve 30-33 dhe 61(3) të Ligjit të Vetingut dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës, procesi i vetingut konstatoi vërtetësinë e deklaratave që përmban deklaratat për vetingun dhe jo të deklaratave të mëparshme të pasurisë. ILDKPKI-ja i kishte vlerësuar pozitivisht; Ligji i Vetingut nuk i autorizonte organet e vetingut t’i rishikonin ato. Në shumë raste, organet e vetingut apo anëtarët e tyre kishin argumentuar se pasaktësitë në deklaratimet periodike nuk justifikonin shkarkimin nga detyra.

ii. Qeveria

140. Kompetencat e organeve të vetingut, të drejtat e palëve dhe kriteret e rivlerësimit parashikoheshin drejtpërdrejt në Kushtetutë dhe u përfshinë në Ligjin e Vetingut. Ato përshkruanin qartë procesin e vetingut si një proces rivlerësimi dhe jo si procedim të zakonshëm disiplinor dhe parashikonin tre rezultate (konfirmim në detyrë, shkarkim nga detyra ose trajnim i detyrueshëm). Procesi i vetingut do të kryhej në bazë të instrumenteve ligjore që tashmë po zbatoheshin nga autoritetet. Vlerësimi i pasurisë ndoqi të njëjtat kriteret rivlerësimi të zbatuara nga ILDKPKI-ja. Ishte hartuar një manual për mënyrën e plotësimit të deklaratimit të pasurisë për vetingun. Objekti i vlerësimit sipas nenit 30 të Ligjit të Vetingut përfshinte verifikimin e deklaratave të pasurisë, kontrollin e deklaratave të pasurisë, verifikimin e legjitimitetit të burimeve të përdorura për krijimin e tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare. Në bazë të nenit 33, organet e vetingut vlerësonin nëse deklarimi ishte i saktë dhe në përputhje me ligjin, nëse subjekti i vetingut kishte burime të ligjshme dhe nëse ato ishin të pamjaftueshme për të justifikuar pasuritë, nëse ai ose ajo kishte fshehur një pasuri, ose kishte kishte bërë një deklarim fals, ose ishte në situatë konflikti interesi. Neni 61(3) parashikonte shkarkimin nga detyra për deklarim të pamjaftueshëm sipas nenit 33. Deklarimi i pamjaftueshëm nënkuptonte mungesë burimesh financiare, fshehje pasurie, deklarim të rremë ose konflikt interesi. Pasaktësitë në deklaratimet e



mëparshme nuk kanë qenë objekt i procesit të vetingut dhe nuk kanë qenë arsye për shkarkim. Këto deklarime shërbenin vetëm për të ndjekur progresin dhe saktësinë e deklaramit dhe për të nxjerrë konkluzione në lidhje me legjitimitetin e pasurive ose mjaftueshmërinë e deklaramive. Kërkuesi ishte vlerësuar vetëm për pronat që ai kishte poseduar atëherë dhe për legjitimitetin e tyre, që përfshinte pagesën e taksave. Arsyeja për shkarkim sipas nenit 61(1) nuk ishte e vetmja bazë ligjore për shkarkim. Arsyeja sipas nenit 61(3) ishte e pavarur.

b) Vlerësimi i Gjykatës

141. Në çështjen *Xboxhaj* (cituar më lart, §§ 385–88), Gjykata arriti në përfundimin se shkarkimi i ankuesit në atë çështje, bazuar në nenin 61 pika 3 dhe 5 të Ligjit të Vetingut, lexuar së bashku me nenin 33 (5) dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës, kishte qenë në përputhje me ligjin në kuptimin e nenit 8 § 2 të Konventës (shih gjithashtu *Sevdari*, cituar më sipër, § 75).

142. Gjykata vëren se thelbi i parashtrimeve të ankuesit në çështjen në fjalë është kryesisht i ngjashëm me argumentet e ngritura para saj në çështjet e sipërpërmendura. Në rastin e tij, KPA-ja iu referua të njëjtave dispozita të Ligjit të Vetingut në lidhje me vlerësimin e pasurisë. Para Gjykatës, kërkuesi parashtroi interpretimin e tij të këtyre dispozitave ligjore, të cilat ndryshonin nga ai i miratuar nga organet e vetingut në rastin e tij, dhe argumentoi, në thelb, se interpretimi i ligjit kishte qenë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Pasi shqyrtoi parashtrimet e palëve dhe materialin në dispozicion, Gjykata vlerëson se në rastin konkret interpretimi i dispozitave ligjore nga organet e vetingut mbi të cilat u bazua shkarkimi i ankuesit nuk ishte arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm (shih *NIT S.R.L. kundër Republikës së Moldavisë* [DHM], nr. 28470/12, § 160, 5 prill 2022; *Valdis Fjölfnisdóttir dhe të tjerët kundër Islandës*, nr. 71552/17, § 64, 18 maj 2021; dhe *Qendra për Demokraci dhe Shtet të së Drejtës kundër Ukrainës*, nr. 10090/16, §§ 108–09, 26 mars 2020; dhe *Juszczyżyn kundër Polonisë*, nr. 35599/20, § 264, 6 tetor 2022).

143. Në veçanti, KPA-ja gjykoi se edhe pse kërkuesi kishte deklaruar një garazh të blerë në vitin 2007 në deklaramin për vetingun në 2017, ai nuk e kishte deklaruar atë në deklaramin(et) vjetore, duke bërë kështu një “deklarim të pasaktë”, rrjedhimisht duke shkelur nenin D § 5 të Aneksit të Kushtetutës

(shih paragrafët 39 dhe 53 më lart). Ai parashikon që nëse personi që do të verifikohet nuk bën deklaramin (për vetingun) brenda afatit të përcaktuar me ligj, ai ose ajo shkarkohet nga detyra. Ai gjithashtu parashikon që nëse personi i rivlerësuar përpiket të fshehtë ose të bëjë një deklarim të pasaktë të një pasurie, do të zbatohet një prezumim në favor të shkarkimit nga detyra. Ndërsa pjesa e parë e kësaj dispozite i referohet qartë detyrimit ligjor të subjektit të verifikimit në momentin e paraqitjes së deklaratës së vetingut, e dyta duket se lejon një interpretim më të gjerë, si p.sh. mosdeklarimi i një pasurie në momentin e marrjes së saj. Interpretimi i ligjit nga KPA-ja nuk duket të ketë qenë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm.

144. Argumentet e tjera të kërkuesit në këtë moment kanë të bëjnë me zbatimin e këtyre dispozitave ligjore, siç interpretohen nga organet e verifikimit, në rrethanat e çështjes së tij, siç përcaktohen prej tyre, dhe kanë të bëjnë me efektet e supozuara joproporcionale të këtij interpretimi. Kjo çështje lidhet me vlerësimin e mëposhtëm nëse ndërhyrja ishte e nevojshme në një shoqëri demokratike (krahaso *Qendra për Demokraci dhe Shtet të së Drejtës*, cituar më lart, § 109).

145. Gjykata arrin në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës private ishte në përputhje me ligjin, siç parashikohet nga neni 8 § 2 i Konventës (shih, në të njëjtën linjë, *Xboxhaj*, cituar më sipër, §§ 385–86, *Sevdari*, cituar më sipër, §§ 70–75 dhe *Nikëhasani kundër Shqipërisë*, nr.58997/18, §§ 99–103, 13 dhjetor 2022).

2. Qëllimi legjitim

146. Parashtrimet e palëve janë të ngjashme me ato në çështjen *Xboxhaj* (cituar më lart, §§ 389–90).

147. Duke vënë në dukje gjetjet në *Xboxhaj* (cituar më lart, §§ 391–93), Gjykata nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimet e ndjekura nga Ligi i Vetingut në përgjithësi, dhe ndërhyrja në këtë çështje (vetingu i një gjyqtari të Gjykatës së Lartë) ishin në përputhje me interesat e sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siç renditen në nenin 8 § 2 të Konventës.

3. E nevojshme në një shoqëri demokratike

a) Parashtrimet e palëve

148. Kërkuesi argumentoi se legjislati nuk parashikonte rregulla në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke përfshirë një shkallë të përshtatshme sanksionesh. Sanksionet ligjore



(pezullimi nga detyra për një periudhë njëvjeçare ose shkarkimi nga detyra) linin pak hapësirë për disiplinimin e gjyqtarit në baza proporcionale dhe për balancimin e interesave konkurruese në faktet e çdo rasti. Shkarkimi i tij kishte qenë në disproporcion me shkeljet disiplinore mbi të cilat ishte bazuar ky vendim, si deklarimi i tij i tepruar i një vlere më të lartë të pronave në Tiranë dhe Shkodër, gabime të vogla formale në deklaratat vjetore të pasurisë dhe mosjustifikimi i disa punimeve rinovimi dhe një pjesë e kursimeve të familjes. Akuzat kishin të bënin me çështje që kishin ndodhur dekada përpara procesit të vetingut. Ai kishte bërë të ditur të gjitha pasuritë në deklaratën e vetingut.

149. Qeveria argumentoi se shkarkimi i kërkuesit nga detyra kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike dhe në proporcion me qëllimet e ndjekura. Sipas tyre, organet e vetingut kishin bërë një vlerësim të plotë të të gjitha aspekteve të çështjes dhe procesi i vendimmarrjes kishte qenë i duhuri.

b) Vlerësimi i Gjykatës

150. Gjykata ka gjykuar më parë, në kuadër të vlerësimit të saj për kërkesën e domosdoshmërisë, se meqenëse në radhë të parë i takon autoriteteve kombëtare, dhe veçanërisht gjykatave, të interpretojnë ligjin e brendshëm, përveç rasteve kur interpretimi është arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, roli i saj kufizohet në verifikimin e përputhshmërisë me Konventën të efekteve të një interpretimi të tillë (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 407; krahaso *Leslaë Wójcik kundër Polonisë*, nr. 66424/09, §§ 125 dhe 134, 1 korrik 2021, në kontekstin e nenit 8 të Konventës).

151. Në këtë mënyrë, Gjykata përsërit se shkarkimi nga detyra është një sanksion disiplinor i rëndë – nëse jo më i rëndi – që mund t'i jepet një individ. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individ, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (shih *Xboxhaj*, cituar më sipër, § 403). Ndërhyrja në të drejtën e respektimit të jetës private do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim legjitim nëse i përgjigjet një “nevoje urgjente sociale” dhe, në veçanti, nëse është në proporcion me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë relevante dhe të mjaftueshme (po aty, § 402).

152. E ndërsa vlerësimi fillestar i domosdoshmërisë i takon autoriteteve kombëtare të, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e paraqitura për ndërhyrjen janë relevante dhe të mjaftueshme, mbetet subjekt i shqyrtimit nga Gjykata për pajtueshmërinë me kërkesat e Konventës (po aty). Gjykata duhet të përcaktojë nëse organet e vetingut kanë tejkaluar marginën e vlerësimit që i takon Shtetit të paditur kur kanë vendosur të shkarkojnë kërkuesin nga detyra. Ajo do të shqyrtojë nëse këto organe kanë kryer një vlerësim individual të faktorëve që çuan në shkarkimin e tij nga detyra sipas vlerësimit të pasurisë.

153. Gjykata rithekson në lidhje me këtë se disa mosrespektime nga zyrtarët publikë të detyrimeve në lidhje me deklaratimet e pasurisë mund të konsiderohen përgjithësisht serioze. Këto mund të përfshijnë, ndër të tjera, mosdeklarimin e pasurisë kryesore ose burimet e të ardhurave ose përpjekjet e qëllimshme për t'i fshehur ato nga autoritetet; pamundësinë për të justifikuar blerjet e mëdha nëpërmjet kursimeve ose burimeve legjitime dhe të mjaftueshme në zotërim në kohën e blerjes; ose mosjustifikimi i një mënyrë jetese të tepruar ose shpenzime ekstravagante që është qartësisht përtej mundësive të deklaruara të ligjshme të zyrtarit përkatës dhe familjes së tij. Mund të jetë legjitime të merren parasysh të ardhurat dhe deklaratimet e bashkëshortit, partnerit ose anëtarit tjetër të familjes së ngushtë të zyrtarit në vlerësimin e pajtueshmërisë së zyrtarit me ligjet kundër korrupsionit (krahaso *me Samoylova kundër Rusisë*, nr. 49108/11, § § 85–86, 14 dhjetor 2021). Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël i mospërputhjes me regjimet e deklaratimit të pasurisë, ose çdo mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme, duhet të passjellë sanksionet disiplinore më të rënda, si shkarkimi nga detyra (shih *Nikëhasani*, § 117 dhe *Sevdari*, § 85, të dyja të cituara më sipër).

154. Për shembull, Gjykata vëren se KPA-ja vlerësoi se shkarkimi i ankuesit nga detyra ishte i justifikuar për shkak të mosdeklarimit ndër vite, deri në deklaratën për vetingun në 2017, të një garazhi të blerë dhe të regjistruar zyrtarisht nga gruaja e tij në 2007, kur familja kishte një bilanc financiar pozitiv dhe ndërkohë që nuk lindte asnjë dyshim për ligjshmërinë ose mjaftueshmërinë e burimeve ose për fshehjen e asaj pasurie (shih paragrafët 39 dhe 143 më lart).



155. Në të njëjtën kohë, Gjykata vëren se vlerësimi u përqendrua në pasuri (banesa) të tjera, më thelbësore, të cilat më pas u përdorën për blerjen e pasurive të mëvonshme të deklaruara në deklaratën e vetingut. Organet e vetingut vlerësuan se, duke pasur parasysh, ndër të tjera, të ardhurat e deklaruara të ligjshme dhe shpenzimet bazë të jetesës së familjes, kërkuesi nuk kishte aftësi kursimi dhe kishte një bilanc negativ për vitet 1992-2003, pra, në periudhën që përkonte me blerjen e dy banesave në vitet 2000 dhe 2003. Gjithashtu, organet e vetingut shprehën dyshime serioze për masën reale të shpenzimeve të bëra për t'i bërë ato banesa të banueshme. Gjykata vlerëson se qasja e organeve të vetingut nuk ishte arbitrare ose haptazi e paarsyeshme në këtë drejtim (shih gjithashtu paragrafin 102 më lart).

156. Kështu, ndërkohë që pasuritë e zotëruara ose të poseduara në kohën e deklarimit të pasurisë për vetingun nuk ishin në diskutim në vetvete në procesin e verifikimit, burimet që u përdorën, të paktën pjesërisht, për blerjen e tyre ngritën problematika në drejtim të origjinës së ligjshme dhe përshtatshmërinë financiare. Duket se të ardhurat nga shitja e banesave të blera përpara procesit të vetingut (në 2000 dhe 2003) dhe kursimet familjare ndër vite janë përdorur më pas për blerjen e pronave të tjera. Kështu, me kërkesë të kërkuesit, organet e vetingut shqyrtuan gjendjen financiare të tij dhe të bashkëshortes së tij për periudhat kur ato banesa ishin blerë, përkatësisht para viteve 2000 dhe 2003. Kërkuesi kishte mundësi të provonte burimet e ligjshme të përdorura për blerjen e tyre, duke përfshirë gjetjet paraprake mbi pabarazinë e dukshme midis të ardhurave, të jetesës dhe shpenzimeve, dhe kursimeve jo pak të rëndësishme të deklaruara se janë përdorur për blerjen e apartamenteve në atë periudhë. Sipas Ligjit të Vetingut, kur një subjekt i vetingut nuk ishte në gjendje të paraqiste dokumentin që justifikonte legjitimitetin e krijimit të një pasurie, ai duhej t'u vërtetonte organeve të vetingut se dokumenti mungonte, kishte humbur ose nuk mund të riprodhohej ose të merrej në një mënyrë tjetër (shih paragrafët 58 dhe 107 më lart). Në rastin konkret, kërkuesi duket se ka ndërmarrë një mënyrë tjetër veprimi, për aq sa ai ka paraqitur një raport eksperti që përmban të dhëna për gjendjen e tij financiare në vitet 1992–2002. Në çdo rast, organet e vetingut në llogaritjet e tyre miratuan një nivel minimal të kostos

së jetesës prej 3 euro në ditë për person, që nuk duket të ketë qenë tepër e lartë.

157. Teksa mori parasysh përshtatshmërinë financiare të kërkuesit vetëm për qëllimet e procesit të vetingut (d.m.th., jashtë çdo konteksti ligjor penal), KPA-ja nxori konkluzione të arsyeshme për rrethanat në lidhje me vlerat e deklaruara dhe reale të apartamenteve të blera nga kërkuesi, në atë kohë gjyqtar i Gjykatës së Rrethit, në vitet 2000 dhe 2003, dhe në lidhje me pagesën e taksës përkatëse (krahaso *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 41087/98, § 53, ECHR 2001-VII; *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 19955/05 dhe 15085/06, §§ 41–42, 23 shtator 2008; dhe *Polyakh dhe të tjerët kundër Ukrainës*, nr. 58812/15 dhe 4 të tjerë, § 296, 17 tetor 2019). Së fundi, KPA-ja gjykoi se pabarazia midis të ardhurave dhe shpenzimeve të ligjshme të kërkuesit në periudhën pas vitit 2003 ishte gjithashtu thelbësore dhe e pajustifikuar, për shkak të bilancit negativ për disa vite (shih paragrafin 41 më lart).

158. Pasi shqyrtoi pretendimet e ankuesit, Gjykata nuk ka identifikuar asnjë mangësi serioze në procesin e vendimmarrjes me të cilën janë arritur gjetjet faktike të lartpërmendura në nivel kombëtar (shih gjithashtu paragrafin 108 më lart). Këto gjetje dhe interpretimi i ligjit kombëtar nuk duket se kanë qenë arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Organet e vetingut vlerësuan se gjetjet në lidhje me vlerësimin e pasurisë justifikonin shkarkimin e kërkuesit nga detyra. Pasi shqyrtoi materialin në dispozicion, Gjykata nuk ka arsye të distancohet nga këto përfundime. Ajo vlerëson se arsyet e paraqitura nga organet e vetingut për të justifikuar shkarkimin e tij nga detyra nën këtë kategori ishin relevante dhe të mjaftueshme, dhe se në rrethanat e çështjes ky vendim ishte proporcional me qëllimet legjitime sipas nenit 8 të Konventës (shih paragrafin 147 lart).

159. Në këtë mënyrë, pavarësisht nga mangësitë procedurale të identifikuara sipas nenit 6 të Konventës në lidhje me vlerësimin e figurës (shih paragrafin 123 më lart), Gjykata vlerëson se shkarkimi i kërkuesit nga detyra ishte i justifikuar si i nevojshëm në një shoqëri demokratike sipas nenit 8 të Konventës për shkak të pasurive të pafavorshme dhe vlerësimit të integritetit financiar.

160. Nisur nga gjetjet e mësipërme, nuk ka nevojë të përcaktohet nëse, përveç vlerësimit të pafavorshëm, shkarkimi i kërkuesit ishte i justifikuar edhe në bazë të komponentit të tretë të procesit të vetingut.



4. Përfundim

161. Gjykata arrin në përfundimin se shkarkimi i kërkesit nga detyra ishte në përputhje me kërkesat e nenit 8 të Konventës.

162. Së fundi, për sa i përket pasojave të caktuara në lidhje me gjetjet e bëra nga organet e verifikimit dhe shkarkimin e ankuesit nga detyra, Gjykata i referohet gjetjeve të saj në *Xboxhaj* (cituar më lart, § 413) dhe vëren se kërkesi nuk ka treguar se shkarkimi i tij nga detyra kishte pasojat e tjera negative, si p.sh. refuzimi i punësimit në një post të caktuar në shërbimin civil ose ndalimi për të kryer veprimtari specifike si ekspert. Rezulton se ai mund të ushtronte profesionin e avokatit (shih paragrafin 134 më lart).

163. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të kërkesit nga detyra.

IV. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS

164. Së fundi, kërkesi pretendoi se ishte shkelur neni 13 së bashku me nenin 8 të Konventës në lidhje me ankesën për shkarkimin e tij nga detyra.

165. Duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e gjetjeve sipas nenit 6 të Konventës, Gjykata nuk e sheh të nevojshme të shqyrtojë pranueshmërinë dhe themelin e kësaj ankese.

V. ZBATIMI I NENEVE 41 DHE 46 TË KONVENTËS

A. Neni 46 i Konventës

166. Neni 46 i Konventës parashikon:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”

167. Ankuesi kërkoi që Gjykata t'i kërkonte Qeverisë së paditur të miratonte masa individuale dhe argumentoi se e vetmja zgjidhje e përshtatshme do të ishte rrimërimi i tij si gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Duke qenë se kishte mangësi strukturore në procesin e verifikimit, rihapja e çështjes së vetingut nuk do të ofronte dëmshpërblim e përshtatshëm. Sistemi i brendshëm nuk kishte dhënë garancitë e duhura kundër abuzimit dhe keqpërdorimit të masave disiplinore në dëm të pavarësisë së gjyqësorit. Nuk kishte asnjë arsye për të supozuar se çështja e tij do të rigjykohej në përputhje me Konventën. Rasti aktual zbuloi gjithashtu një

problem sistematik që kërkonte masa të karakterit të përgjithshëm. Kërkesa të ngjashme ishin pezull në Gjykatë dhe mund të pritej një fluks çështjesh të përsëritura që rridhnin nga i njëjti problem struktural ose sistematik.

168. Qeveria nuk ra dakord.

169. Parimet e përgjithshme në lidhje me detyrimet e Shtetit të paditur sipas nenit 46 të Konventës në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve në të cilat Gjykata konstatoi shkelje të Konventës janë përcaktuar, ndër të tjera, në *Oleksandr Volkov* (cituar më sipër, §§ 193–95, me referenca të mëtejshme). Vendimet e Gjykatës janë në thelb deklarative në natyrë. Neni 46 ka në përmbajtje një detyrim ligjor për të zgjedhur, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është e përshtatshme, individuale që do të miratohen në rendin e tij ligjor të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe të bëjë të gjitha dëmshpërblimet e mundshme për pasojat e saj në mënyrë të tillë që të rikthejë sa më shumë të jetë e mundur situatën në gjendjen që ishte përpara shkeljes (po aty).

170. Gjykata nuk ka konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me gjetjet e organeve të verifikimit mbi vlerësimin e pasurisë (shih paragrafin 163 më lart). Ajo gjithashtu ka shqyrtuar, për herë të parë, një ankesë sipas nenit 6 të Konventës në lidhje me vlerësimin e figurës dhe ka konstatuar një shkelje të kësaj dispozite për shkak të disa mangësive që dalin nga faktet specifike të çështjes në fjalë (shih paragrafin 123 më lart). Duke pasur parasysh juridiksionin e saj dhe natyrën dhe shtrirjen e shkeljes së konstatuar, Gjykata refuzon kërkesën e kërkesit që Gjykata t'i kërkojë Qeverisë ta rrimërojë atë në detyrë (shih *Besnik Cani*, cituar më sipër, § 150). Gjykata nuk e sheh të përshtatshme të përcaktojë përjashtimisht ndonjë masë të përgjithshme që mund të merret për t'i dhënë fund shkeljes në fjalë (krahaso *Oleksandr Volkov*, cituar më lart, §§ 199–202).

B. Neni 41 Konventës

171. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”



1. Dëmi

172. Ankuesi kërkoi 200,000 euro (EUR), në lidhje me dëmin jopasuror: 16,239 euro në lidhje me dëmin pasuror për shkak të humbjes së pagës midis periudhës korrik 2018 dhe nëntor 2020; dhe shuma të papërcaktuara që korrespondojnë me pagën, shtesat dhe kontributet e pensionit që ai do të kishte të drejtë të merrte nga shkarkimi deri në rikthimin e plotë në detyrë, ose nëse nuk do të rikthehej, që korrespondojnë me pagën që do të kishte të drejtë të merrte deri në moshën e daljes në pension dhe pensionin e vjetërsisë që do të kishte të drejtë të merrte në bazë të jetëgjatësisë mesatare.

173. Qeveria i kundërshtoi pretendimet.

174. Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës së kërkuesit për një gjykim të drejtë sipas nenit 6 § 1 të Konventës dhe asnjë shkelje të nenit 8. Gjykata nuk konstaton ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar procedurale dhe dëmit material të pretenduar; prandaj e hedh poshtë këtë pretendim (krahaso *Besnikë Cami*, cituar më lart, §§ 127–29 dhe 134). Gjykata vlerëson gjithashtu se konstatimi i shkeljes së nenit 6§1 të Konventës përbën në vetvete një kompensim të drejtë të mjaftueshëm për sa i përket dëmit jopasuror në çështjen në fjalë (po aty, § 135).

2. Kostot dhe shpenzimet

175. Kërkuesi kërkoi 12,896 euro për tarifën e avokatëve të tij në Gjykatë, të paguara sipas faturave të lëshuara në 2018 dhe 2020 nga studioja e tyre ligjore në Itali.

176. Qeveria deklaroi se ato fatura të panënshkruara nuk ishin paguar dhe se, duke pasur parasysh të ardhurat e kërkuesit, ato nuk mund të paguheshin. Në çdo rast, shpenzimet nuk ishin të nevojshme sipas kuantitetit, duke pasur parasysh kostot e zakonshme ligjore në Shqipëri.

177. Një kërkues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për atë që është dëshmuar se këto janë kryer realisht dhe domosdoshmërisht, dhe janë të arsyeshme për sa i përket sasisë. Duke pasur parasysh dokumentet në posedim të Gjykatës dhe praktikën gjyqësore të saj (shih *Vegotex International S.A. kundër Belgjikës* [DHM], nr. 49812/09, §§ 167–68, 3 nëntor 2022, dhe *Beeler kundër Zvicrës* [DHM], nr. 78630/12, § 128, 11 tetor 2022) dhe për atë që kërkesa lidhet me çështjen në fjalë dhe me një konstatim shkeljeje, Gjykata akordon 3,500 euro, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

Për këto arsye, Gjykata

1. *I deklaron*, në mënyrë unanime, ankesat e bëra në mbështetje të nenit 6 (në pjesën në lidhje me të drejtën për një gjykim të drejtë) dhe nenit 8 (në lidhje me shkarkimin nga detyra) të Konventës të pranueshme;

2. *I deklaron*, me shumicë, ankesat e tjera bërë në mbështetje të Neneve 6 dhe 8 të Konventës të papranueshme;

3. *Gjykon*, në mënyrë unanime, se është shkelur neni 6 i Konventës;

4. *Gjykon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se është shkelur neni 8 i Konventës;

5. *Gjykon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa e bërë në mbështetje të nenit 13 të Konventës;

6. *Gjykon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete mjaftueshëm gjykim të drejtë për dëmin jopasuror që ka pësuar kërkuesi;

7. *Gjykon*, në mënyrë unanime,

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuesit, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 3,500 euro (tre mijë e pesëqind euro) plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit, për kostot dhe shpenzimet, të konvertuara në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

b) se që nga përfundimi i periudhës tremujore të përmendur më sipër dhe deri në shlyerje, ndaj shumës së mësipërme do të paguhet interes i thjeshtë në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonësës së pagesës plus tre pikë përqindje;

8. *Rrëzon*, me gjashtë vota pro dhe një kundër, pjesën e mbetur të pretendimit të kërkuesit për gjykim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 korrik 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova
Zëvendëssekretare

Pere Pastor Vilanova
Kryetar



Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, këtij vendimi i është aneksuar opinionioni i mëveçantë i Gjyqtarit Serghides.

P.P.V.
O.C.

OPINIONI PJESËRISHT KUNDËRSHTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

Ndërsa unë jam dakord me pikat 1, 3 dhe 7 të parashikimeve operative të vendimit, në lidhje me pikat 2, 4, 5, 6 dhe 8, në vend të një opinionioni të mëveçantë të plotë ose një vote anonime kundër këtyre pikave, unë kam zgjedhur të bashkëlidh këtë “deklaratë të hapur kundërshtuese”. Kjo është një deklaratë e thjeshtë mosdakordësimi me një pjesë të vendimit, një nga mënyrat për të shprehur kundërshtinë, të cilën gjyqtarët kanë të drejtë ta përdorin në mbështetje të Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës.

VENDIM Nr. 46, datë 3.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 3.10.2023. mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1 (G) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Gëzim Boçari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Trajtimit të Pronave,

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Avokatura e Shtetit.

OBJEKTI: Konstatimi se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përcaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile.

Anulimi i vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Përsheptimi i gjykimit dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, e kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, pika 3, 41, pika 2, 122, pika 2, 131, pika 1, shkronja “P”, 181, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 2, 27, 28, 29, 30, 49, pika 3, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP) dhe Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuari Gëzim Boçari¹ së bashku me shtetasit A.Gj., K.Gj., S.Gj., A.Gj. e E.Gj., në cilësinë e trashëgimtarëve të shtetasve E.D. dhe M.D. (Gj.), i janë drejtuar me kërkesë Zyrës Rajonale të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (ZRAKKP) Vlorë për njohjen e së drejtës së pronësisë mbi një sipërfaqe 950 vreten, të ndodhur në rrethin e Vlorës. Me vendimin nr. 58, datë 31.8.2007, ZRAKKP-ja, Vlorë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për shkak të mangësisë dhe të metave në dokumentacionin ligjor, si dhe për shkak të mbivendosjes që krijon planvendosja me

¹ Sipas vendimeve gjyqësore mbiemri i kërkuarit rezulton Gjonboçari.



disponimet e bëra me vendimet nr. 38, datë 18.5.1994, nr. 38/1, datë 18.5.1994 dhe nr. 81, datë 14.6.1995, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë dhe vendimin nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë, i ndryshuar me vendimin nr. 18, datë 15.1.2008, të drejtorit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), për njohjen dhe kthimin fizikisht të disa pasurive të paluajtshme, sipërfaqe toke, trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarit I. A., si dhe vendimin nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, me të cilin është njohur pronar dhe i është njohur e drejta e kompensimit shtetases K.B. Vendimi i ZRAKKP-së Vlorë është kundërshtuar në AKKP, e cila ka vendosur lënien e tij në fuqi me vendimin nr. 415, datë 22.4.2008, me të njëjtin arsyetim.

2. Po mbi kërkesën e të njëjtave subjekte, ZRAKKP-ja, Vlorë, me vendimin nr. 59, datë 31.8.2007, ka vendosur mosnjohjen e së drejtës së pronësisë së trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënës M.D.(Gj.) për një sipërfaqe toke 150 vreten, të ndodhur në rrethin e Vlorës, me arsyetimin se pretendimet e kërkuësve nuk janë provuar dhe se kjo pasuri krijon mbivendosje me disponimet e bëra me vendimin nr. 38/1, datë 19.5.1994, të KKKP-së, Vlorë dhe nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë. Edhe ky vendim është kundërshtuar në AKKP, e cila, me vendimin nr. 414, datë 22.4.2008, ka vendosur lënien e tij në fuqi. Trashëgimtarët ligjorë të ish-pronarëve E.D. dhe M.D.(Gj.) i janë drejtuar gjykatës me kërkesëpadi, me objekt anulimin e tyre, si dhe detyrimin e të paditurve F.M., P.G., M.G., S.L., Z.V., M.Xh., K.B. dhe A.L. t'i njohin pronarë për ato sipërfaqe që janë trajtuar me vendimet objekt padie dhe që janë brenda pronës së pretenduar nga paditësit, si dhe detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë të regjistrojë këto prona dhe t'i regjistrojë në favor të paditësve.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1814, datë 6.7.2009, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor. Mbi bazën e ankimit të veçantë të paditësve, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.11.2009, ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, të cilat, me vendimin nr. 2, datë 21.1.2011, kanë vendosur prishjen e vendimit

të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes po asaj gjykate për vazhdimin e gjykimit.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1056, datë 23.6.2014, ka vendosur të pranojë pjesërisht padinë, duke pranuar kërkimet për: konstatimin si akt absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së Vlorë, të dhënë në favor të K.B., për rrjedhojë edhe të kontratës së dhurimit të datës 10.9.1999, të lidhur ndërmjet saj dhe E.L.; njohjen dhe kthimin fizik të pasurisë 4131,8 m² në parcelën nr. 31, Jonufër, Vlorë bashkëtrashëgimtarëve të ish-pronarëve E.D. dhe M.D.(Gj.); detyrimin e palëve të paditura K.B. dhe E.L. të njohin si pronarë paditësit për këtë pasuri (pikat 7–9 të dispozitivit). Në lidhje me kërkimet e tjera gjykata ka vendosur rrëzimin e tyre dhe konkretisht ato për: anulimin pjesërisht të vendimeve nr. 38, datë 18.5.1994, nr. 38/1, datë 18.5.1994 dhe nr. 81, datë 14.6.1995, të KKKP-së, Vlorë, nr. 52, datë 13.8.2007, të ZRAKKP-së, Vlorë dhe nr. 18, datë 15.1.2008, të AKKP-së (pikat 1–5 të dispozitivit); detyrimin e palëve të paditura, trashëgimtarë të ish-pronarit I.A., të njohin si pronarë paditësit për pronat e individualizuara në mbivendosje (pika 6 e dispozitivit); anulimin e vendimeve të kthimit dhe kompensimit të pronave, me të cilat është refuzuar kthimi i pronës që nuk krijon mbivendosje me të paditurit dhe për pjesën që krijon mbivendosje me palët e paditura trashëgimtarë të I. A. (pika 10 e dispozitivit); detyrimin e ZVRPP-së, Vlorë të regjistrojë pasuritë e paluajtshme në favor të paditësve (pika 11 e dispozitivit). Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim paditësit, si dhe të paditurit K.B. dhe A.L.

5. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 329, datë 15.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1056, datë 23.6.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në lidhje me pikat 2, 3, 4, 5, 6, 10 dhe 11 të tij dhe ndryshimin e vendimit në pikat 1, 7, 8, 9 dhe 12, duke vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi Gëzim Boçari në datën 19.11.2017, i cili është regjistruar në Gjykatën e Lartë me numër nr. 11111-01272-00-2018, datë 16.4.2018.

6. Për shkak se për çështjen e tij nuk kishte ende një datë të planifikuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, në datën 3.10.2022, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e gjykimit, në situatën që kishte kaluar



një periudhë prej më shumë se 4 vjetësh nga regjistrimi i saj, duke pretenduar se është shkelur afati i parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, pasi është njohur edhe me mendimin me shkrim të gjyqtarit relator, me vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Sipas tij, çështja e ka kaluar afatin e shqyrtimit në atë gjykatë, siç përcaktohet në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, dhe kërkuesi nuk ka pasur sjellje që të kenë shkaktuar vonesa të paarsyeshme në gjykim, por, nga ana tjetër, nuk vlerësohet se vjen ndonjë rrezik i veçantë për të nga mosgjykimi në afat i kësaj çështjeje. Vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, që lidhet me efektet e reformës në drejtësi (*shih paragrafët 17 dhe 18, të vendimit të Kolegjit Penal*). Në kushtet kur Gjykata e Lartë është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përsheptimin e kësaj çështjeje, pasi janë shumë çështje të tjera më të vjetra se ajo, me të njëjtën shkallë apo edhe shkallë më të lartë përparësie, të cilat presin për gjykim, nuk mund të gjejë zbatim mekanizmi zhblllokues, për shkak të parashikimit të nenit 399/2, pika 3, të KPC-së (*shih paragrafin 33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

8. Me kërkesën e datës 30.1.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përsheptimin e procedurave për gjykimin e çështjes së tij civile të regjistruar në atë gjykatë, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mosshqyrtimi i saj brenda afatit ligjor.

9. Me vendimin e datës 5.4.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Me vendimin e datës 13.4.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës së një anëtarë të saj për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, kurse me vendimin e datës 18.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, në mënyrë të përmblëdhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor për sa vijon:

10.1 Procesi gjyqësor në tërësi ka zgjatur mbi 14 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në Gjykatën e Lartë. Edhe pse Kolegji Penal ka konstatuar shkeljen e afatit 2-vjeçar të gjykimit, nuk është shprehur për përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit siç përcakton neni 399 i KPC-së. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ka konstatuar shkeljen e neneve 6, pika 1 dhe 13 të Konventës, duke ndëshkuar shtetin shqiptar, ndërkohë që ekzekutimi i tij mbahet peng nga shqyrtimi i çështjes së kërkuetit.

10.2 Konflikti duhej të ishte zgjidhur nga ATP-ja pa pasur nevojë për proces gjyqësor, duke plotësuar mangësinë materiale, që është firma pro ose kundër e kryetarit të komisionit në vendimin e KKKP-së nr. 109 të vitit 1996. Mosekzekutimin e vendimit nr. 502, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Lartë, për të cilin GJEDNJ-ja ka dënuar shtetin shqiptar, e vërteton edhe dokumenti i Zyrës Përmbartimore nr. 676 prot., datë 5.10.2020.

10.3 Kërkesa për përsheptim nuk u mor në konsideratë edhe pse bashkëlidhur saj u paraqit dokumenti i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë që provon se gjatë kohës që po zhvilloheshin proceset gjyqësore prona i është nënshtruar një afere korruptive, duke bërë pronarë persona të tretë, të cilët nuk kanë asnjë të drejtë trashëgimie. Privatizimet e pronës janë bërë mbi shkresa abuzive dhe pa bazë ligjore, çka është shkelje e nenit 92 të Kodit Civil. Ndaj vendimi i Kolegjit Penal mbron transferimin e paligjshëm të trojeve që u përkasin familjes Boçari.

10.4 Në vijim të vendimeve abuzive në pronën e konfiskuar familjes Boçari në vitin 1947, është edhe vendimi nr. 00-2022-1098 (242), datë 10.6.2022, i Kolegjit Civil, çështje për të cilën edhe pse u kërkuar të bashkohet me çështjen që ndodhet në pritje të gjykimit, kjo nuk u mor në konsideratë. Moshqyrtimi së bashku i këtyre çështjeve ka mundësuar deformimin tërësisht të provave dhe ka maskuar mungesën e bazës ligjore të kërkesës së



paraqitur nga P.G. për rishikimin e vendimit nr. 199, datë 6.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

10.5 Rreziku nga shtyrja e afateve kohore do të sjellë pasoja të parikuperueshme, pasi kompensimi nga zbatimi i projektit “Lungomare 3”, që do të fillojë në vitin 2023, do të përfitohet nga familja e shtetasit I.A. dhe persona të tjerë që nuk kanë asnjë dokument autentik të kohës për të provuar se janë pronarët e shpronësuar. Vendimi i Gjykatës së Lartë maskon faktin se subjekti i shpronësuar, familja Boçari, ka paraqitur kërkesëpadinë e datës 7.1.1993, për njohjen pronar dhe kthim sendi, si dhe faktin se objektet e privatizuara janë ndërtime provizore, baraka të rrënuara të ngritura në trojet e pronarit dhe mbi themelet e ndërtimeve ekzistuese të tij. Për procesin që kërkohet të përshpejtohet dokumentet e pronësisë për familjen Boçari nuk kundërshtohen, pasi janë nxjerrë nga Arkiva e Shtetit.

11. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

11.1 Pretendimet e kërkesit janë haptazi të pabazuara, pasi vendimmarrja e Gjykatës së Lartë është ezauruese dhe e mbështetur në parashikimet e nenit 399/5 të KPC-së, duke respektuar kufijtë e objektit të kërkesës dhe dispozitave ligjore. Kërkimet dhe argumentet e kërkesit krijojnë kontradiktoritet me objektin e kërkit pranë Gjykatës së Lartë, pasi ai ka pretenduar se ajo duhej të ishte shprehur për pretendimet e paraqitura në rekurs, ndërkohë që konstatimi i shkeljes së afatit ligjor nuk ka lidhje me pretendimet për themelin e çështjes.

11.2 Në lidhje me kriterin e periudhës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata e Lartë ka konstatuar se është kaluar afati i shqyrtimit në atë gjykatë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së, por kjo vonesë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Për sa i përket kompleksitetit të çështjes, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, pasi thelbi i saj lidhet me mbrojtjen e së drejtës së pronës private, ndaj përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 dhe shqyrtimi i saj paraqet elemente kompleksiteti.

11.3 Kriteri i interesit dhe sjelljes së kërkesit ka të bëjë me mënyrën se si janë sjellë palët në proces dhe faktorë të tjerë lidhur me veprimet ose mosveprimet e tyre, që kanë ndikuar në ecurinë e procesit. Lidhur me sjelljen e autoriteteve, sipas vendimit të Kolegjit Penal, gjyqtari relator ka marrë në shqyrtim kërkesën për përshpejtim dhe është

shprehur se është duke marrë masat maksimale për përballimin e çështjeve të prapambetura dhe shqyrtimin e tyre sa më parë të jetë e mundur. Ligjvënisi ka parashikuar shprehimisht rrethanat e pamundësisë objektive si shkak objektiv që shkarkon nga përgjegjësia për tejkalimin e afatit.

11.4 Pretendimi për shpërblimin e dëmit nuk bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal është pjesa finale e procedurës për-shpërblimin e drejtë. Në kushtet kur Gjykata e Lartë është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e çështjes, nuk mund të gjejë zbatim mekanizmi zhbllokues.

11.5 Për sa i përket pretendimit për ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ai është i pabazuar dhe nuk përbën objekt shqyrtimi në rastin konkret. Për ekzekutimin e atij vendimi, që i detyronte autoritetet të ekzekutonin vendimin nr. 502, datë 6.3.2003, të Gjykatës së Lartë, AKKP-ja ka marrë vendimin nr. 45, datë 11.3.2009, që bazohej në dosjen e pronës nr. 578/2, për të cilën ishte marrë vendimi nr. 109 i vitit 1996, i KKKP-së, me të cilin u ka njohur të drejtën e pronësisë paditësve për sipërfaqen 819,917 m², në vendin e quajtur “Shkalla”, Jonufër, Vlorë, u ka kthyer sipërfaqen 484,551 m² dhe i ka kompensuar për sipërfaqen 321,766 m². Janë vetë paditësit që kanë kundërshtuar në gjykatë vendimet e KKKP-së dhe AKKP-së.

12. *Subjektet e interesuara, ATP-ja dhe ASHK-ja,* nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo



rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë, për të cilin ka ngritur pretendime në drejtim të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm.

15. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata vëren se pas ndryshimeve që iu bënë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, ajo ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 3, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individit duhet t’u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 44, datë 26.9.2023; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual pasi ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në atë gjykatë, për të cilën Kolegji Penal, me vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, ka vendosur rrëzimin e saj. Për rrjedhojë, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së pretenduar të cenuar është ankimi kushtetues individual.

17. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave mban datën 17.11.2022, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 30.1.2023, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, në thelb, objekt i ankimit kushtetues individual është kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuesit të regjistruar në Gjykatën e Lartë, për të cilën ende nuk ka një vendimarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Edhe pse kërkuesi ka ngritur disa pretendime që lidhen me të drejtën e pronës dhe paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona të tretë, apo të drejtat potenciale që mund t’u burojnë atyre nga pasuritë objekt të mosmarrëveshjes civile, ai i ka lidhur ato me vonesat në shqyrtimin e çështjes së tij. Për rrjedhojë, Gjykata do t’i vlerësojë pretendimet e kërkuesit vetëm në këndvështrim të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor të kundërshtuar, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

19. Për sa i përket kërkimit për shpërblimin e dëmit për shkak të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, Gjykata thekson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, shqyrtimi i këtyre kërkesave nuk bën pjesë në juridiksionin e saj, prandaj kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 17, datë 29.6.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

20. Sipas kërkuesit, procesi gjyqësor në tërësi ka zgjatur mbi 14 vjet, nga të cilat mbi 5 vjet në Gjykatën e Lartë. Edhe pse Kolegji Penal ka konstatuar shkeljen e afatit 2-vjeçar të gjykimit, nuk është shprehur për përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit siç përcakton neni 399 i KPC-së. Shqyrtimi i çështjes së tij mban peng edhe ekzekutimin e vendimit të GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë, ndërkohë që vendimi i Kolegjit Penal mbron transferimin e paligjshëm të trojeve që u përkasin familjes Boçari. Po kështu, rreziku nga shtyrja e afateve kohore do të sjellë pasojat të parikuperueshme, pasi kompensimi nga zbatimi i projektit “Lungomare 3”, që do të



fillojë në vitin 2023, do të përfitohet nga familja e shtetasit I. A. dhe persona të tjerë që nuk kanë asnjë dokument autentik të kohës për të provuar se janë pronarët e shpronësuar.

21. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjykata, lidhur me kohëzgjatjen tërësore të çështjes, duke iu referuar rrethanave të saj (*shih paragrafët 1-7 të vendimit*), konstaton se ajo është regjistruar në gjykatën e shkallës së parë fillimisht më 30.5.2009 dhe pas kthimit nga Kolegjet e Bashkuara është regjistruar në po atë gjykatë më 1.8.2011 dhe deri në dhënien e vendimit të gjykatës së apelit (15.3.2017), gjykimi i saj ka zgjatur rreth 8 vjet. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, në Gjykatën e Lartë është regjistruar çështja nr. 11111-01272-00-2018, datë 16.4.2018. Për qëllime të këtij gjykimi Gjykata ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë në lidhje me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i kësaj çështjeje. Me shkresën nr. 4564/1 prot., datë 20.9.2023, Gjykata e Lartë ka kthyer përgjigje se aktualisht çështja është në fazën e studimit dhe se ende nuk ka një planifikim për marrjen e saj në shqyrtim nga trupa gjyqësore e Kolegjit Civil. Për rrjedhojë, çështja e kërkuesit në Gjykatën e Lartë është në pritje të shqyrtimit prej më shumë se 5 vjetësh.

23. Gjykata vëren se me ndryshimet e KPC-së të vitit 2017, në parashikimet ligjore për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ligjvënësi ka përcaktuar afatin 2-vjeçar për përfundimin e gjykimit civil në Gjykatën e Lartë, që zgjatet edhe me 1 vit e 6 muaj të tjerë në rastin kur çështjet gjyqësore janë ende në proces gjykimi në kohën e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve (neni 109, i ligjit nr. 38/2017). Për rrjedhojë, duke konsideruar se çështja e kërkuesit ndodhet në pritje të shqyrtimit në Gjykatën e Lartë prej më shumë se 5 vjetësh, duke tejkaluar kështu

afatin e parashikuar për këtë lloj gjykimi nga KPC-ja, për të vlerësuar arsyeshmërinë e kësaj kohëzgjatjeje dhe për të arritur në përfundimin nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese për proces të rregullt në këtë aspekt, Gjykata zbaton këto kritere: *i.* sjelljen e kërkuesit; *ii.* kompleksitetin e çështjes; *iii.* sjelljen e autoriteteve; *iv.* rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 34, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Sjellja e kërkuesit

24. Sipas jurisprudencës kushtetuese vlerësimi i sjelljes së kërkuesit është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse ai ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të, dhe nëse është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 37, datë 5.11.2021; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Pasi ka pritur planifikimin e datës për shqyrtimin e rekursit të tij, kërkuesi i është drejtuar fillimisht Gjykatës së Lartë me kërkesën e datës 3.10.2022, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, në përputhje me parashikimet e neneve 399/1 e vijues të KPC-së, dhe pasi është njohur me vendimin e Kolegjit Penal të asaj gjykate, që ka vendosur rrëzimin e kërkesës, ka paraqitur ankim kushtetues individual me të njëjtin objekt. Për rrjedhojë, kërkuesi dhe paditësit e tjerë në procesin gjyqësor kanë vepruar në përputhje me të drejtat e tyre procedurale dhe nuk rezulton të jenë bërë shkak ose të kenë shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjes.

ii. Kompleksiteti i çështjes

26. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile dhe thelbi i saj lidhet me mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës private, ndaj ky gjykim përfshihet në fushën e zbatimit të nenit 42 dhe shqyrtimi nga Gjykata e Lartë paraqet elemente kompleksiteti.

27. Gjykata ka theksuar se në vlerësimin e kompleksitetit të çështjes marrin rëndësi të gjitha aspektet e saj, përfshirë objektin, faktet e kundërshtuara, volumin dhe natyrën e provave, llojin dhe ndërthurjen e ligjeve të zbatueshme, si dhe numrin e palëve pjesëmarrëse në proces.



Kohëzgjatja e konsiderueshme e gjykimit mund të justifikohet nga kompleksiteti i çështjes, pasi balancohet nga parimi i administrimit të përshtatshëm të drejtësisë (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi, edhe pse në dukje paraqitet komplekse, ajo nuk do të shqyrtohet në rastin konkret në këtë drejtim, për sa kohë që vetë Gjykata e Lartë nuk e ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit në drejtim të elementeve që përcaktojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, por ka vendosur rrëzimin e saj mbi konsiderata që lidhen me rrethanat objektive, referuar situatës së përgjithshme në sistemin gjyqësor.

29. Gjykata, megjithatë, vlerëson të theksojë se kompleksiteti i çështjes nuk mbartet në të njëjtën mënyrë në çdo shkallë të gjykimit, por varet nga faza në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj dhe shkalla e gjykimit në të cilën kërkohet konstatimi i kohëzgjatjes së paarsyeshme. Me fjalë të tjera, edhe pse kjo çështje, referuar objektit të saj, numrit të palëve ndërgjyqëse dhe volumit të akteve shkresore e dokumenteve të administruara në gjykim, mund të mbartë kompleksitet gjatë gjykimit të saj në gjykatat e faktit, kjo mund të mos jetë e tillë në Gjykatën e Lartë, për shkak të natyrës së atij gjykimi dhe procedurës së gjykimit në dhomën e këshillimit, si dhe funksionit të saj si gjykatë e ligjit, pavarësisht kuadrit ligjor të zbatueshëm dhe ndryshimeve të vazhdueshme e të shpeshta përgjatë viteve si të akteve ligjore, ashtu edhe të atyre nënligjore. Pra, gjykimi në gjykatën e ligjit nuk mund të thuhet se paraqet të njëjtat elemente kompleksiteti si në shkallët e tjera të gjykimit.

iii. Sjellja e autoriteteve

30. Sipas subjektit të interesuar, Avokaturës së Shtetit, referuar vendimit të Kolegjit Penal, gjyqtari relator, pasi është njohur me kërkesën për përshpejtim dhe e ka marrë në shqyrtim, është shprehur se është duke marrë masat maksimale për përballimin e çështjeve të prapambetura dhe shqyrtimin e tyre sa më parë të jetë e mundur. Edhe referuar nenit 399/2, pika 3, të KPC-së në kohëzgjatjen e gjykimit nuk llogaritet koha kur shfaqen rrethana të pamundësisë objektive për procedim.

31. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për

organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se nismat procedurale u takojnë palëve, kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së (*shih vendimet nr. 38, datë 25.4.2017; nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Gjykata, duke pasur parasysh efektet që solli reforma në sistemin e drejtësisë, ka theksuar se parashikimi i një reforme të kësaj natyre nuk mund të justifikojë vonesat, pasi shteti është i detyruar të organizojë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Në këtë drejtim, akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, në rast se ka ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës dhe zgjidhjen e saj. Pavarësisht se ka disa metoda që mund të zbatohen nga gjykatat për të nxitur përkohësisht përshpejtimin e gjykimit të çështjeve, nëse edhe një zgjidhje e tillë rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive dhe të organizojë sistemin gjyqësor, në mënyrë që të garantohet e drejta për të marrë një vendim përfundimtar brenda një periudhe të arsyeshme (*shih vendimet nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022; nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Edhe pse sistemi gjyqësor në tërësi po përballlet me ngarkesë, si rezultat i zbatimit të kësaj reforme, kjo problematikë e përgjithshme nuk mund të rëndojë ose të justifikojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të kërkuarve (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 25, datë 11.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në këtë kuptim, vetëm ato vonesa që i atribuohen shtetit mund të justifikojnë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pasi ai është përgjegjës për të gjitha autoritetet shtetërore, jo vetëm organet gjyqësore. Sipas GJEDNJ-së, ndërkohë që neni 6 kërkon që procedurat gjyqësore të jenë të shpejta, ai, gjithashtu, vë theksin në parimin më të përgjithshëm të administrimit të duhur të drejtësisë (*shih Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë (vendim) [DhM], maj 2021, § 132*). Megjithatë, një



mbingarkesë kronike nuk mund të justifikojë zgjatjen e tepërt të procedurave (*shih Probstmeier kundër Gjermanisë, 1997, § 64*). Metodën që mund të konsiderohen si një mjet i përkohshëm përfshijnë zgjedhjen për t'i trajtuar çështjet në një rend të caktuar, bazuar jo vetëm në datën e paraqitjes, por në shkallën e tyre të urgjencës dhe të rëndësisë dhe, në veçanti, në rëndësinë e asaj që rrezikojnë personat e interesuar. Megjithatë, nëse një situatë e tillë zgjatet dhe bëhet çështje organizimi strukturor, metoda të tilla nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave efektive (*shih Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, 1983, § 29; Guincho kundër Portugalisë, 1984, § 40*). Fakti që situata të tilla të prapambetura janë bërë të zakonshme nuk justifikon zgjatjen e tepërt të procedurave (*shih Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, 1989, § 40*).

34. Gjykata rithekson, siç evidentoi në lidhje me kriterin e kompleksitetit të çështjes (*shih paragrafin 28 të vendimit*), se në vendimin e Kolegjit Penal mungon analiza dhe arsyetimi në lidhje me plotësimin e kriterëve që justifikojnë arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor, duke e bazuar qëndrimin e tij në faktin se vonesa në shqyrtimin e çështjes së kërkuarit në atë gjykatë është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, që lidhet me efektet e reformës në drejtësi dhe se ajo është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e kësaj çështjeje, pasi janë shumë çështje të tjera më të vjetra, me të njëjtën shkallë apo edhe shkallë më të lartë përparësie, të cilat presin për gjykim (*shih paragrafët 17, 18 dhe 33, të vendimit të Kolegjit Penal*).

35. Gjykata vlerëson të theksojë se zanafilla e këtij procesi është sjellja e autoriteteve, e cila është bërë shkas për lindjen e konfliktit gjyqësor të iniciuar nga kërkuari për mbrojtjen e së drejtës së pronës private të pretenduar të cenuar për shkak edhe të veprimeve të organeve administrative. Kjo çështje ka mbi 5 vjet që është në pritje të gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe ende nuk ka një perspektivë të qartë se kur do të gjykohet. Për rrjedhojë, duke pasur parasysh këtë fakt, si dhe faktin që pretendimet kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë së kërkuarit, Gjykata arrin në përfundimin se sjellja e autoriteteve shtetërore nuk ka qenë në nivelin e duhur të efikasitetit.

in. Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuari

36. Kriteri i interesit të kërkuarit dhe rëndësisë së asaj që ai rrezikon nga tejzgjatja e procedurave

përbën një aspekt të rëndësishëm të vlerësimit të kohëzgjatjes së arsyeshme të gjykimit. Gjykata vëren se pretendimet e tij, në thelb, kanë të bëjnë me njohjen e pronësisë për disa pasuri të paluajtshme, për të cilat paditësit, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të ish-pronarëve, kanë kërkuar njohjen dhe kthimin ose kompensimin e tyre nga organet administrative.

37. Në lidhje me procesin në pritje të gjykimit në Gjykatën e Lartë, ai ka të bëjë me kundërshtimin e vendimeve të organeve administrative që janë shprehur për të drejtën e pronës së paditësve, si dhe të vendimeve të organeve administrative që kanë disponuar në favor të disa personave të tjerë (pala e paditur në procesin gjyqësor) për disa pasuri që ata pretendojnë se mbivendosen me pasuritë e tyre, padi që është rrëzuar me vendim të gjykatës së apelit. Objekt i këtij gjykimi është edhe konstatimi absolutisht i pavlefshëm i vendimit nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, të dhënë në favor të shtetas K. B., për rrjedhojë edhe i kontratës së dhurimit të datës 10.9.1999, të lidhur ndërmjet saj dhe shtetasit E. L.

38. Rezulton, gjithashtu, se kërkuarit kanë iniciuar disa procese gjyqësore që lidhen me pasuritë të paluajtshme të ndodhura në rrethin e Vlorës dhe po kështu, rezulton se vendimi i KKKP-së nr. 63, datë 19.10.1997, ka qenë objekt edhe i një procesi tjetër gjyqësor të vënë në lëvizje nga paditësit, që më tej është kundërshtuar prej tyre në GJEDNJ. Më konkretisht, kërkuari Gëzim Boçari ka kërkuar në gjykatë dhënien e formës ligjore vendimit nr. 109, datë 27.8.1996, të KKKP-së, Vlorë, me të cilin trashëgimtarëve të paditësve u është njohur dhe kthyer një sipërfaqe toke truall 6100 m², e ndodhur në Jonufër, Vlorë, akt ky që i mungonte forma, pasi kishte mungesë të nënshkrimeve të anëtarëve të komisionit. Po kështu, ai ka kërkuar edhe anulimin e vendimit të KKKP-së nr. 63, datë 19.10.1997, me pretendimin se ka mbivendosje me pronën e tij. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 195, datë 6.2.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 295, datë 25.5.2001. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 502, datë 6.3.2003, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe detyrimin e KKKP-së, Vlorë, të nxjerrë vendimin në formën e kërkuar nga ligji dhe pushimin e gjykimit në lidhje me kërkimin për vendimin nr. 63, datë



19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, duke vlerësuar se ky kërkim është i lidhur me kërkimin e parë të padisë.

39. Kërkuesi i është drejtuar GJEDNJ-së për shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë dhe tejzgjatjes së procedurave gjyqësore (*aplikimi nr. 10508/02*). GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 23.10.2007, ka gjetur shkelje të Konventës për shkak të mosekzekutimit të vendimit të Gjykatës së Lartë për rreth 4 vjet nga data e marrjes së tij (*shih Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë*, §§ 53, 54). Pasi ka marrë në shqyrtim edhe kohëzgjatjen e të tria proceseve gjyqësore në të cilat ankuesit ishin palë, GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se kohëzgjatja e procesit që ka të bëjë me procedurat për kthimin e pronës shtetas K.B. nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 6 të Konventës (*po aty*, §§ 67, 68).

40. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, konstaton se pas vendimit të sipërcituar të GJEDNJ-së, mbi bazën e kërkesës së një prej trashëgimtarëve të familjes Boçari për kthimin e një sipërfaqeje kullotë, tokë bujqësore dhe truall me sipërfaqe 819,917 m², të ndodhur në Jonufër, Vlorë, ZRAKKP-ja, Vlorë, me vendimin nr. 45, datë 11.3.2009, ka vendosur të njohë të drejtën e pronësisë mbi këtë sipërfaqe, të kthejë sipërfaqen e përgjithshme 494,551 m² trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar A.D. dhe M.D. (Gj.), të mos kthejë sipërfaqen 325,366 m², pasi është e zënë, si dhe të njohë të drejtën e kompensimit për sipërfaqen 321,766 m². Sipas këtij vendimi prona e pretenduar ka mbivendosje me pasuritë e njohura dhe të kthyer trashëgimtarëve të shtetasit I.A. dhe se brenda kësaj pasurie është disponuar në emër të shtetas K. B. me vendim të KKKP-së të vitit 1997.

40. Duke pasur parasysh sa më sipër, çështja në pritje të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë ka për objekt të saj të drejtën e pronësisë së kërkuesve, e cila pretendohet se është cenuar edhe për shkak të akteve administrative të kundërshtuara gjyqësisht që u kanë njohur palëve të paditura të drejtën e kthimit ose kompensimit fizik mbi pasuri për të cilat paditësit pretendojnë se ka mbivendosje me pronën që u buron nga trashëgimia, mes të cilave edhe vendimi nr. 63, datë 19.10.1997, i KKKP-së Vlorë. Gjykata ka theksuar se zgjidhja përfundimtare e problemeve që kanë të bëjnë me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, si çështje jo vetëm me interes publik, por, para së gjithash, me natyrë

kushtetuese, përbën prioritet, pasi e drejta e pronës përbën një nga shtyllat kryesore ku mbështetet sistemi ekonomik dhe zhvillimi i vendit (*shih vendimin nr. 1, datë 6.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Për më tepër, siç evidentohet edhe në vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë dhe siç rezulton edhe nga aktet e dosjes gjyqësore, ka disa procese gjyqësore të iniciuara nga paditësit, ndërkohë që ata nuk kanë ende një vendim përfundimtar të gjykatës në lidhje me të drejtën e tyre të pronësisë të pretenduar të cenuar. Për rrjedhojë, duke mbajtur në vëmendje rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor.

42. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe përsheptimit të procedurave, është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa duhet të pranohet pjesërisht. Për më tepër, Gjykata vëren se për pjesën takuese të pronës së paditësve, për të cilën është disponuar me vendimin nr. 63, datë 19.10.1997, të KKKP-së, Vlorë, vonesat në këtë gjykim kanë bërë të pazbatueshëm, pjesërisht, edhe vendimin e GJEDNJ-së në çështjen Gjonboçari e të tjerë kundër Shqipërisë.

43. Bazuar në nenin 81, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata çmon të caktojë afatin 6-mujor brenda të cilit duhet të veprojë Gjykata e Lartë, pasi në vlerësimin e saj ky afat konsiderohet i arsyeshëm në raport me të drejtën kushtetuese të kërkuesit, por, gjithashtu, u përgjigjet kushteve dhe mundësive aktuale të asaj gjykate.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,



VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm.
4. Detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11111-01272-00-2018 akti brenda 6 muajve.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 3.10.2023.

Shpallur më 1.11.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë : Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtare kundër: Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes nr. 1 (G) 2023 të Regjistrat Themeltar, që i përket kërkuarit Gëzim Boçari, me objekt: *“Konstatimi se vendimi nr. 18, datë 17.11.2022, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën për gjykim brenda afateve ligjore, përcaktuar nga neni 399 i Kodit të Procedurës Civile. Anulimi i vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Përsheptimi i gjykimit dhe shpërbllimi i dëmit të shkaktuar nga zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, e kërkuar me kërkesën e datës 3.10.2022”*, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica për sa i përket zgjidhjes së kësaj çështjeje, pasi vlerësoj se duhej të ishte vendosur rrëzimi i kërkesës.

2. Në analizë të kriterëve vlerësues të kohëzgjatjes së afateve të gjykimit, për kriterin *“Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar”*, shumica ka vlerësuar se: *“...duke mbajtur në vëmendje gjetjet e GJEDNJ-së në vendimin e datës 23.10.2007 për çështjen e kërkuarit për tejzgjatjen e procedurave të ekzekutimit të vendimit gjyqësor, si dhe rëndësinë që ka e drejta kushtetuese e pronës private, nga e cila rrjedh edhe e drejta për ta gëzuar e disponuar atë, si dhe e drejta e kompensimit, sipas kuadrit ligjor në fuqi, kohëzgjatja e procedurave gjyqësore në rastin*

konkret ka rëndësi në drejtim të asaj që rrezikojnë paditësit si palë në procesin gjyqësor”. (shih paragrafin 41 të vendimit). Në përfundim, shumica ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm dhe detyrimin e Gjykatës së Lartë për të gjykuar çështjen gjyqësore nr. 11111-01272-00-2018 akti, brenda 6 muajve, duke vlerësuar se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor dhe përsheptimit të procedurave, është i bazuar, ndaj kërkesa duhet të pranohet pjesërisht.

3. Në drejtim të rrezikut që passjell për kërkuarin tejzgjatja e procedurave, vlerësoj se, në thelb, kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit, pasi ajo çfarë kërkuar rrezikon në këtë konflikt gjyqësor nuk përfshihet në të drejta dhe interesa të natyrës veçanërisht serioze. Duke konsideruar dhe analizuar më në thellësi se çfarë pasoje ose rreziku sjell për kërkuarin tejzgjatja e procesit, çmoj se shumica duhej të kishte dalë në konkluzion të ndryshëm për çështjen.

4. Në vlerësimin tim, referuar analizës së vendimit të Gjykatës së Lartë, objekt ankimi kushtetues individual, rezulton se kjo e fundit nuk ka cenuar kriteret kushtetuese të kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit gjyqësor, duke marrë në konsideratë secilën prej tyre dhe në tërësi çështjen.

5. Konkretisht, në përgjigje të shkresës së datës 17.10.2022, të kancelarit të gjykatës, gjyqtari relator, të cilit i ka kaluar për shqyrtim çështja e themelit të kërkuarit, ka paraqitur mendimin e tij me shkrim, duke argumentuar se në Kolegjin Civil të kësaj gjykate ndodheshin për shqyrtim 18.000 çështje civile dhe se po shqyrtoheshin çështje më të hershme në kohë, sipas datës së regjistrimit, kriter ky i përcaktuar në nenin 460 të KPC-së, ku më e hershmeja i përkiste vitit 2011. Po sipas relatorit, kolegji kishte në shqyrtim në seancë gjyqësore çështje që u përkisnin viteve 2011, 2012, 2013 dhe në dhomë këshillimi çështje të regjistruara në vitin 2014. Çështja e kërkuarit ishte regjistruar në vitin 2018 dhe asaj nuk mund t'i jepej përparësi, pasi nuk paraqiste shkaqe të veçanta që prevalonin mbi kriterin e radhës së regjistrimit, referuar vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së. Po kështu, në vlerësim të



kërkesës së kërkuarit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka pranuar se çështja e kishte kaluar afatin e shqyrtimit të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së (2 vjet në kushtet e ometimit në Gjykatën e Lartë), pasi nga data e regjistrimit të saj kishin kaluar më shumë se 4 vjet, ndërkohë që ka çmuar se kërkuar nuk i vinte ndonjë rrezik i veçantë nga mosgjykimi në afat i çështjes (*shih vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqet 3 dhe 5, paragrafët 9 dhe 17*).

6. Po sipas Gjykatës së Lartë, askujt nuk mund t'i kërkohej të bëjë të pamundurën dhe për më tepër të bëhet përgjegjës për pamundësinë objektive absolute për evadimin e çështjeve, në kushtet e një numri të kufizuar burimesh njerëzore dhe një numri tepër të lartë të stokut të çështjeve. Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe urdhërimi i marrjes së masave konkrete për përshpejtimin e gjykimit është një institut që synon të korrektojë rastet e pakujdesive ose veprimeve të parregullta të gjykatave në planifikimin e gjykimit në kohë të çështjeve. Ky institut synon të rregullojë anomali individuale dhe zbatohet në ato rastet kur gjykimi jashtë afateve të arsyeshme është përjashtim dhe jo rregull praktik (për shkak të ngarkesës së madhe dhe mungesës së theksuar të burimeve njerëzore). Në kushtet kur situata objektive është e tillë që nuk mund të rregullohen anomalitë, pasi objektivisht nuk mund të procedohet me gjykimin e çështjeve, me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë, nuk ka vend që të urdhërohet shqyrtimi me përshpejtim i kësaj çështjeje, duke lënë pa gjykuar çështje të tjera të ngjashme apo më urgjente e më të vjetra, të cilat edhe ato duhet të gjykohen sipas radhës së paraqitjes në gjykatë (*shih vendimin nr. 18, datë 17.11.2022, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, faqja 6, paragrafi 21*).

7. Në linjë të këtij arsyetimi, si gjyqtare në pakicë, çmoj të rëndësishme të sjell në vëmendje edhe qëndrimin e Gjykatës në lidhje me garancinë e parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së për sa i përket detyrimit për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda një afati të arsyeshëm.

8. Kështu, në drejtim të kriterit “Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar”, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përshpejtim të posaçëm të gjykimit. Në këto raste duhet të merret

parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuarit në procesin gjyqësor, pra rëndësia për kërkuarin e së drejtës objekt gjykimi. Kjo do të thotë se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë”, siç janë ato të kujdestarisë, marrëdhëniet e punës, lipset të trajtohen me përparësi dhe shpejtësi të veçantë, të cilat duhet të mbahen në konsideratë gjatë gjykimit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 35, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, në zbatim të parimit *minimis non curat praetor*, që pretendimet për cenimin e një të drejte të merren në shqyrtim prej saj, duhet të arrihet një nivel minimal rrezikshmërie. Përcaktimi i këtij niveli minimal është relativ dhe varet nga rrethanat e çështjes konkrete (*shih vendimin nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në këndvështrim të vlerësimit të kriterit “Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuar” sipas jurisprudencës kushtetuese, sikundër theksova dhe më lart, çmoj se në rastin e kërkuarit nuk është interpretuar drejt nga shumica, pasi një kriter i tillë nuk lidhet me llojin e së drejtës së kontestuar, por me cilësitë e veçanta të kërkuarit ose natyrën e çështjes së themelit, për shqyrtim në gjykatën në vonesë, e cila për shkak të tejzgjatjes edhe mund të humbasë si e drejtë dhe të mos arrihet të rivihet në vend për shkak të tejzgjatjes së paarsyeshme. Një interpretim i këtij kriteri sipas qëndrimit të mbajtur nga shumica, pra duke e lidhur atë me thelbin e së drejtës së pretenduar si të cenuar, për të cilën është vënë në lëvizje procesi gjyqësor (rasti konkret e drejta e pronës), do të thotë se katalogu i të drejtave themelore, të parashikuara nga nenet 21–58 të Kushtetutës, duhet të trajtohet nga gjykatat e zakonshme sipas kategorizimit të të drejtave kushtetuese, dhe e drejta e pronës duhet të jetë më e rëndësishme për interesat e kërkuarve se sa të drejtat e tjera kushtetuese (*shih paragrafin 41 të vendimit*), hierarki kjo që do të përmbyste konceptin e përparësisë në radhën e shqyrtimit të çështjeve, çka bie ndesh me thelbin dhe qëllimin e këtij kriteri kushtetues, si kriter që në situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor duhet të përbëjë dallimin në përcaktimin e përparësisë së shqyrtimit të çështjeve.

10. Për më tepër, duke pranuar se ka shkelje të kohëzgjatjes së arsyeshme dhe duke vendosur detyrim për Gjykatën e Lartë, që brenda 6 muajve të shqyrtojë themelin e çështjes, shumica nuk ka reflektuar qasjen e duhur as mbi efektivitetin e



vendimeve të saj, të cilat rrezikojnë të mbeten të pazbatuara, dhe as në pamundësinë ose mundësinë e kësaj gjykate për të shqyrtuar këtë çështje. Në këtë drejtim, ajo nuk ka qartësuar se mbi çfarë kriteresh e konsideron afatin 6-mujor të arsyeshëm dhe që u përgjigjet kushteve e mundësive të Gjykatës (relatorit) për të vepruar në çështjen e kërkuarit. Nga ana tjetër, vendimi nr. 78/2019 i KLGJ-së, për sa i përket kategorisë, ka parashikuar se kërkojnë, gjithashtu, përparësi në përshpejtim çështjet që duhen shqyrtuar për shkak të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese (*shih pikën 3.2, kreu II, të vendimit nr. 78/2019 të KLGJ-së*), një arsye më tepër për të pasur kujdes në vënien e afateve, që mund të krijojnë përplasje me kalendarin e çështjeve, ku ka çështje më prioritare sipas informacionit mbi këtë çështje. Duke iu rikthyer të dhënave statistikore, rezulton se gjyqtari relator, të cilit i ka kaluar për shqyrtim çështja e themelit të kërkuarit, ka paraqitur mendimin e tij me shkrim, duke argumentuar se: i. në Kolegjin Civil të kësaj gjykate ndodheshin për shqyrtim **18.000 çështje civile**; ii. po shqyrtoheshin çështje më të hershme në kohë, sipas datës së regjistrimit, **ku më e hershja i përkiste vitit 2011** dhe se kolegji kishte në shqyrtim në seancë gjyqësore çështje që u përkisnin viteve 2011, 2012, 2013; iii. çështja e kërkuarit **ishte regjistruar në vitin 2018** dhe asaj nuk mund t'i jepej përparësi, pasi nuk paraqiste shkaqe të veçanta që prevalonin mbi kriterin e radhës së regjistrimit. Në këtë kontekst faktesh, qasja e shumicës nuk duket realiste, vjen si e shpëputur nga realiteti kompleks i organizimit dhe funksionit të gjyqësorit të zakonshëm aktualisht, edhe pse vetë vendimi objekt ankimi individual e pasqyron më së miri këtë realitet me mbingarkesë çështjesh gjyqësore.

11. Ky qëndrim i pakicës nuk nënkupton në asnjë rast që sistemi gjyqësor nuk duhet të jetë në përputhje me parimin e drejtësisë efektive, megjithatë kjo Gjykatë krahas sigurimit të njëtrajtshmërisë të jurisprudencës kushtetuese, për sa i takon vlerësimin të faktorëve që duhet të garantojnë standardet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet edhe të konstitucionalizojë gjyqësorin e zakonshëm përmes vendimeve të saj. Gjykata, duke mos zbatuar kriteret të sakta dhe të

qarta, po i orienton këto lloj procesesh gjyqësore në subjektivizëm, duke sjellë pasoja edhe për gjyqësorin e zakonshëm, në lidhje me kriterin “*Rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuari*”.

12. Për të gjitha argumentet e mësipërme, në rastin konkret, në ndryshim nga shumica, çmoj se çështja e kërkuarit, e cila ka të bëjë me njohjen e së drejtës së pronësisë për sipërfaqet e pretenduara, për nga natyra e saj nuk kërkon të trajtohet më me përparësi se çështje të tjera, pasi interesi i kërkuarit nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.

13. Në këto kushte, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes konkrete, kompleksitetin e saj, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuarit, vlerësoj se nuk ka cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, për rrjedhojë kërkesa duhej rrëzuar.

14. Përveç sa më lart, theksoj se ky qëndrim është në të njëjtën koherencë sikundër edhe në çështje të tjera, përkatësisht në vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 25, datë 11.5.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës, për të cilat kam mbajtur të njëjtin qëndrim.

Anëtare: Elsa Toska

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me vendimin nr. 530 (3497), datë 18.7.2023, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Eralba Mehaj, e datëlindjes 29.10.1994, lindur dhe banuese në Shkodër, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë ligjore të kërkuarës Fatbardha Tahiraj.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë